



Përkthimi dhe adaptimi i këtij publikimi ishte rezultat i bashkëpunimit mes Odës Ekonomike Amerikane në Maqedoni, Ambasadës së SHBA-ve në Maqedoni dhe Enti Shtetëror për të Drejta Industriale i Republikës së Maqedonisë.

Për të shkarkuar këtë publikim në gjuhën maqedonishte ose shqipe, ju lutemi të vizitoni lidhjen: <http://www.amcham.com.mk>.

Për gjitha informacionet tjera lidhur me të drejtat e pronave industriale dhe intelektuale në Maqedoni, ju lutemi vizitoni lidhjen: <http://www.ippo.gov.mk>.

#### Abdikime:

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është të ofrojë informata elementare, nuk është synuar si zëvendësim për: këshillim profesional juridik. Përmendja e emrave të firmave dhe organizatave dhe ueb faqeve të tyre nuk përputhet me miratimin e OBPI.

Ky publikim është përkthyer dhe riprodhuar me lejen e Organizatës Botërore të Pronës Intelektuale (OBPI), pronari i të drejtave të autorit, në bazë të versionit origjinal në gjuhën angleze. Sekretariati i OBPI-së nuk merr asnjë detyrim ose përgjegjësi në lidhje me përkthimin dhe transformimin e këtij publikimi.

MËSONI NGA E KALUARA, KRIJONI ARDHMËRINË

# ARTET DHE TË DREJTAT E AUTORIT



# PËRMBAJTJA

## PARTHËNIE

### ARTET

- ◆ Çka janë artet dhe pse janë të rëndësishme?
- ◆ Kush i krijon artet?
- ◆ Lojë: Bashkimi i emrit me veprën e autorëve të rinj
- ◆ Si krijojnë autorët?
- ◆ Si fitojnë autorët të hollat me veprat e tyre?

### TË DREJTAT E AUTORIT

- ◆ Çfarë janë të drejtat e autorit?
- ◆ Çfarë mbrojnë të drejtat e autorit?
- ◆ Çfarë janë kushtet për të drejtat e autorit?
- ◆ Si merren të drejtat e autorit?
- ◆ Kush i posedon të drejtat e autorit?
- ◆ A janë të drejtat e autorit të njëjta në gjithë botën?
- ◆ Çfarë ofrojnë të drejtat e autorit?
- ◆ Sa është kohëzgjatja e të drejtave të autorit?
- ◆ A mund të transferohen të drejtat e autorit?
- ◆ Lojë: Detektivi i të drejtave të autorit
- ◆ Çfarë janë të drejtat e lidhura?
- ◆ Aktivitet për krijimtari
- ◆ Si menaxhohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura?
- ◆ Lojë: Caktoni të drejtat

### DOMENI PUBLIK DHE KUFIZIMET E TË DREJTAVE TË AUTORIT

- ◆ Çfarë është domeni publik?
- ◆ Si mund të përdoren veprat e domenit publik?
- ◆ Lojë: kërkim pasurie në domenin publik
- ◆ Ku mund të gjenden veprat e domenit publik?
- ◆ Çfarë janë kufizimet e të drejtave të autorit?



## **CENIMI I TË DREJTAVE TË AUTORIT**

- ◆ Çfarë është cenimi i të drejtave të autorit?
- ◆ Çfarë është plagjiatura?
- ◆ Çfarë është pirateria?
- ◆ Çfarë është shkëmbimi i skedarëve mes bashkëmoshatarëve? (peer-2-peer)?
- ◆ Lojë: mbrojtja e autorëve dhe performuesve
- ◆ Çfarë është administrimi i të drejtave digjitale?
- ◆ Si mund të mbrohen veprat në internet?
- ◆ Lojë: Gjejeni cenimin

## **MENDIME TË FUNDIT**

## **PËRGJIGJET E LOJËRAVE**

## **LETRA PËR KËRKIMIN E LEJES**

- ◆ Modeli i letrës për kërkimin e lejes

## **FJALORTH**

## **REKOMANDIME TJERA**

## **BIBLIOGRAFIA E ZGJEDHUR**

## **BURIME NË INTERNET**

## **SHËNIME PËR MËSIMDHËNËSIT**

# PARTHËNIE

"Të drejtat e autorit dhe Artet" është publikimi i dytë i serialit Mësoni nga e kaluara, krijoni ardhmërinë e OBPI-së synuar për nxënësit e rinj. Ky serial ishte lansuar si njohje e rëndësisë së fëmijëve dhe të rinjve si krijues të ardhmërisë sonë.

Publikimi fillon me një sqarim të shkurtë mbi rëndësinë e arteve dhe potencialin e të rinjve për të qenë autorë mahnitës. Kjo pjesë synon të inkurajojë të rinjtë të përdorin imagjinatën, fleksibilitetin dhe vetë-shprehjen për të krijuar vepra origjinale artistike. Gjithashtu, segmentet Autori i ri që paraqitet vazhdimisht në publikimin inkurajon lexuesit duke treguar si të rinjtë tjerë janë duke krijuar vepra dhe duke përdorur të drejta të autorit për t'i mbrojtur.

Pjesa kryesore e publikimit ofron informacione elementare mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura. Pastaj, vijon pjesa dedikuar për të treguar nxënësve si të gjejnë dhe të përdorin veprat në domenin publik.

Pjesa e fundit e publikimit sqaron tre llojet e zakonshme të cenimit të të drejtave dhe si mund të shmangen. Kjo pjesë në veçanti tregon sfidat që paraqesin teknologjitë digjitale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit për veprat.

Në fund të publikimit janë dhënë informacione plotësuese në të cilën janë përfshirë një fjalorth i të drejtave të autorit dhe një shembull të letrës që mund të përdoret për të kërkuar leje për përdorimin e veprave të mbrojtura me të drejta të autorit.

# ARTET

## Çka janë artet dhe pse janë të rëndësishme?

Të gjitha artet janë shprehje kreative. Njerëzit mund të shprehin kreativitetin e tyre:



vizuelisht



me lëvizje



me zë



në tre dimensione



me shkrime




nëpërmjet multimediasë

Shprehjet kreative në artet quhen **vepra**. Shembuj të veprave janë: piktura, fotografi, këngë, poezi, drama, koreografi, skulptura, ndërtesa, filma dhe loja kompjuterike.

### Autor i ri: Alexandra Nechita

Alexandra, e cila ka lindur në Rumani, ka filluar të vizatojë dhe të pikturojë kur i ka pasur vetëm dy vjet. Që prej atëherë ajo ka kaluar orë të shumta duke pikturuar forma abstrakte me ngjyra të ndritshme për të krijuar pëlhura të mahnitshme që janë lavdëruar nëpër tërë botën. Veprat e saja vlerësohen me mijëra dollarë e madje mund të gjenden nëpër muze. Alexandra nuk pret që njerëzit të kuptojnë domethënien e pikturave të saja. Në vend të kësaj, ajo që është e rëndësishme për të është që ata të cilët i shohin veprat e saja të ndiejnë ndjenjat e shprehura në pikturat. Pikturimi e bën Alexandra të lumtur dhe kjo ndjenjë shfaqet në veprat e saja. Ajo ka shprehur ndjenjat e saja pozitive në piktura, skulptura e madje edhe në monedha komemorativë që promovojnë paqen.

"Është ndjenja, është humori që ju shkakton një gjë ose ndodhi, të cilën do ta pikturoni. Nuk është ajo gjëja vetë. Nëse pikturoj një llambë, unë e pikturoj domethënien që ajo llambë ka për mua." (Alexandra në një intervistë për Orange County Register në qershor 2003)



Fotolëndërim prej: Alexandra Nechita

**Artet na ndihmojnë të kuptojmë dhe të komunikojmë me kultura të ndryshme.** Me ndarjen e ideve dhe ndjenjave, artet e hapin mendjen tonë dhe na çojnë të mendojmë. Ato na ndihmojnë të shohim botën ndryshe, nëpërmjet mendjes së krijuesit. Edhe pse ndoshta nuk e kuptojmë gjuhën të cilën e flet artisti, akoma mundemi të kuptojmë ndjenjat dhe idetë e tij kur të dëgjojmë muzikën e tij ose kur të shohim pikturat e saja. Nuk mund të përshkruhet me fjalë se sa na ndihmon arti për tu lidhur me njerëz nga kultura të ndryshme, pa marrë parasysh gjuhën dhe pengesa tjera.

### Autor i ri: Kishan Shrikanth

Kur i kishte gjashtë vjet, Kishan u interesua për gjendjen e fëmijëve të marginalizuar të cilët shpesh i shihte si shesin gazeta në rrugët e qytetit në Indi. Ai donte t'ju ndihmojë këtyre fëmijëve dhe vendosi të bëjë këtë duke shkruar një tregim nëpërmjet të cilit më shumë njerëz do të dinë për këta fëmijë jetimë të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë në shkollë. Me ndihmë dhe kurash nga familja dhe shokët, ai filloi të gjirojë një film të bazuar në këtë tregim kur i kishte vetëm dhjetë vjet (me këtë fitoi vend në Librin e rekordeve Guinness). Ai ka përdorë kreativitetin dhe përvojën e tij në prodhimin e filmave (ai aktron që nga mosha katër vjeçare) për të informuar botën për gjendjen e rëndë të fëmijëve të rrugës. Filmi i tij, *c/o Footpath*, është tregim për një fëmijë të rrugës i cili lufton për mundësinë për të shkuar në shkollë. Ai shpreson që ky film do të nënvizojë rëndësinë e shkollimit dhe t'ju jap më shumë mundësi dhe inspirim fëmijëve të lagjeve të varfra të shkojnë në shkollë.

Kishan ka përdorë filmin për të zmadhuar të kuptuarit e rëndësisë së shkollimit të të gjithë fëmijëve.



Fotografia prej: chitraranga.com

### Artet na argëtojnë.

Paramendoni një botë pa muzikë që mund ta dëgjoni, pa libra për të lexuar, pa filma për të shikuar ose video loja për të luajtur. Nuk ka dyshim që pa vepra artistike, jeta do të ishte shumë më pak interesante.

### Artet shërojnë.

Pa marrë parasysh a nëpërmjet këngë, piktura ose tregime, artet u ndihmojnë njerëzve të shprehin dhe të merren me ndjenjat e tyre gjatë kohëve të rënda.

## Autor i ri: Corneille

Në moshën 16-vjeçare, talenti i Corneille-it si këngëtar dhe muzikant ishte njohur në Çmimet Discovery të vendlindjes së tij Ruanda, të cilët janë transmetuar në televizor. Sidoqoftë, vitin e ardhshëm, ndodhi tragjedi. Corneille ka parë si i vrasin familjen e tij dhe mezi se ka shpëtuar edhe vetë. Pas kësaj Corneille ka kaluar një periudhë shumë të rëndë si refugjatë, e më në fund është vendosur në shtëpia të reja në Gjermani dhe Kanada. Gati se dhjetë vjet pas shfaqjes së tij në televizion në Ruanda, Corneille ka nxjerrë albumin e tij të parë *Parce qu'on vient de loin* (Pasi që vijmë nga larg). Corneille ka shkruar, kompozuar dhe ka kënduar të gjitha këngët në albumin e tij si një mënyrë për tu hequr nga tmerret që e ndjekin pasi humbi familjen e tij. Ritmet e tija soul dhe R&B me tekst francez flasin për përjetimet e tija të kaluara, por gjithashtu festojnë jetën e tij të re. Muzika e Corneille-it nuk i ndihmoi veç të shërojë plagët e tija, por gjithashtu preki zemrat e qindra mijëra adhuruesve të cilët e kanë bërë këngëtar më të madh në kohët e fundit që flet gjuhën franceze. Corneille tani i ndihmon Kryqit të Kuq të Kanadasë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), me pjesëmarrje në koncerte dhe duke shkruar këngë të cilat shërojnë plagët e fëmijë që vuajnë në vende të ndryshme të botës.

*D'ailleurs je chante souvent pour ne pas crier* ( Shpesh këndo për të mos bërtitur) - Tekst nga kënga e Corneille, *Seul au monde* (Vetë në botë).



Fotolënderim prej: corneille.ca

### **Artet na ndihmojnë të kuptojmë historinë.**

Nëpërmjet arteve mundemi të kuptojmë më mirë botën tonë dhe të mësojmë për historinë dhe kulturën. Civilizimet e kaluara shpesh mbahen në mend dhe kuptohen duke falënderuar arteve të tyre - arkitekturës, letërsisë, pikturave, skulpturave, muzikës dhe vallëzimit. Art i vjetër sa vizatimet në shpella, mite të lashta dhe këngë tradicionale na ndihmojnë të kuptojmë se si kanë jetuar më parë njerëzit.


### **Artet janë aktivitet i rëndësishëm ekonomik.**

Artet janë pjesë e industrisë së kulturës, e cila krijon vende pune dhe jep kontribut për pasurinë në shtetet ku prodhon veprat origjinale. Serialet Harry Potter, të cilët kanë argëtuar miliona njerëz rreth botës, në një shembull të përkryer për atë se si artet kanë dhënë kontribut për punësimin dhe për pasurinë e një shteti. Vetëm mendoni se sa vende pune janë krijuar për të prurë tregimin e këtij magjistari të ri tek fansat e tij nëpër tërë botën.

Njerëzit të cilët kanë fituar nga suksesi i këtij seriali përfshijnë:

- ◆ Autoren, J.K. Rowling.
- ◆ Publikuesit, editorët, përkthyesit, shtypësit dhe tregtarët të cilët kanë prodhuar versione në gjuhë të ndryshme të këtij libri.
- ◆ Prodhuesit, udhëheqësit, kompozitorët muzikor, teknikët dhe të gjithë të punësuarit tjerë të përgjegjshëm për të bërë filma të bazuar në këto libra.
- ◆ Dizajnesit, zhvilluesit e softuerit, prodhuesit, shitësit me pakicë, shpërndarësit dhe punëtorët në fabrika dhe dyqane që prodhojnë dhe shpërndajnë asortimanin e gjerë të lojërave dhe prodhimeve tjera të bazuara në këto seriale.
- ◆ Udhëheqësit e turneve dhe punëtorët në hotele dhe restorante që gjenden në afërsi të vendeve të vizituara nga turistë të cilët duan të shohin vendet ku janë gjiruar filmat.

Serialet Harry Potter kanë krijuar mijëra vende pune dhe të ardhura për punëtorë nëpër tërë botën.



## Mendoni:

- Shikoni rreth jush dhe identifikoni të gjitha artet rreth jush.
- Çka ju tregojnë këto arte për kulturën e autorëve të cilët i kanë krijuar ato?
- Çfarë lloj arti ju pëlqen më së shumti? Pse?
- Çka keni mësuar nga arti?
  - A mund të numëroni një ose më tepër persona që kanë të ardhura nga artet?

## Kush i krijon artet?

*Çdo fëmijë është artist. Problemi është si të mbetet artist kur të rritet.*

- Pablo Picasso

**Autorët** janë njerëz të cilët krijojnë vepra. Arkitektët, piktorët, kompozitorët, fotografët dhe artistët tjerë, të gjithë janë autorë të veprave të tyre. Çdo herë që shkruajmë, vizatojmë ose bëjmë një fotografi edhe ne krijojmë punimin tonë të veçantë. Në këtë kuptim, të gjithë jemi autorë.

Çdokush ka talent kreativ që mund të shprehet nëpërmjet arteve. Në veçanti njerëzit e ri kanë kualitete që mund t'i bëjnë autorë më kreativ sesa shumë njerëz tjerë të rritur. Këto përfshijnë:

**Imagjinata:** Njerëzit e ri kanë imagjinatë të gjallë. Pasi që kanë më pak shpresë se si duhet të jenë gjërat, mendjet e tyre mund të shëtisin në drejtime që çojnë në vepra të reja dhe origjinale.



**Fleksibiliteti:** Njerëzit e ri janë më spontan dhe më pak gjykues sesa të rriturit. Andaj, ata janë më të hapur për ide të reja dhe për eksperimentim me teknika të ndryshme.

**Shprehja e vetes:** Njerëzit e ri janë më të mirë se sa të rriturit në shprehjen dhe ndarjen e mendimeve dhe ndjenjave të tyre. Kjo lehtësi me shprehjen e vetes liron kreativitetin në artin e tyre.

### Autor i ri: George Pocheptsov

George ka shfaqur kreativitetin e tij në letër qëkur ka vizatuar vizatimet e tija të para si foshnje prej 17 muajsh. Kreativiteti i tij i papërmbajtur ka rezultuar në pëlhura të shumëngjyrshme të mbuluara me kafshë imagjinare, engjëj dhe personazhe të cilat e shprehin se si e sheh ai botën. George ka mësuar veten të pikturojë dhe ai kënaqet me eksperimente me format e kafshëve imagjinare të cilat i vizaton dhe me teknika të ndryshme pikturimi. Bota e tij 'prej letrë' është e inspiruar nga natyra, muzika dhe tregimet. Veprat e tija, shpesh të krahasuar me Pikason, shiten për mijëra dollarë.

Pikturat e George Pocheptsov janë shprehje me ngjyra të imagjinatës së tij.




### Mendoni:

- Çfarë lloj arti keni qejf të krijoni?
- Çka ju inspiron kur krijoni?
- Çka doni të shprehni në veprat tuaja artistike?
  - A janë veprat tuaja artistike hobi apo doni të jetoni nga ky aktivitet?

## Lojë: Bashkimi i emrit me veprën e autorëve të rinj\*

Shumë autorë të njohur kanë filluar të krijojnë vepra në moshë të herët. A mund të gjeni cili autor kur e ka bërë punimin e parë?

Betoven



- ka pikturuar portretin e vetë të parë në moshën 19-vjeçare.

Frida Kahlo



- ka shitur vizatimet e para në moshën 7-vjeçare.

Mary Shelley




- ka publikuar veprat e para muzikore në moshën 12-vjeçare.

Mocart




- ka filluar të shkruaj romanin e parë në moshën 18-vjeçare.

Pikaso



- ka shkruar kompozimin e parë muzikor në moshën 5-vjeçare.

Walt Disney



© Disney Enterprises, Inc.

- ka mbaruar pikturën e parë të njohur në moshën 8-vjeçare.

\* Shihni faqen 58 për përgjigje

## Si krijojnë autorët?

Krijimi i punimit artistik ka nevojë për shumë më tepër sesa inspirim dhe kreativitet i thjeshtë. Shumica e autorëve studiojnë dhe ushtrojnë orë të shumta para se të prodhojnë një punim të përfunduar. Ndonëse autorë të ndryshëm përdorin teknika të ndryshme kur krijojnë, ka së paku katër hapa të cilat shumica prej tyre i kalojnë:

1. Bëjnë një **skicë** të punimit. Kjo mund të jetë pamje e përafërsisht e një fotografie, konturë e një tregimi ose zgjidhje e fjalëve kryesore të një poezie ose kënge.
2. **Zhvillim** i skicës duke i dhënë më tepër formë dhe përmbajtje.
3. **Përmirësim** i skicës me shtim të detajeve dhe fshirje të elementeve të panevojshme.
4. Prodhim i kopjes **përfundimtare** të punimit.

Gjatë këtij procesi, autorët zakonisht gjejnë inspirim në vepra tjera artistike. Për shembull, një piktor mund të jap ide për tregim ose dëgjimi i muzikës mund të inspirojë një piktor. Studimi i veprave tjera gjithashtu i përmirëson aftësitë e autorit. Kjo është një nga shkaqet pse shumica e autorëve kanë qejf të dëgjojnë, lexojnë ose të shikojnë veprat e autorëve tjerë.

## Mendoni:

Përdorni hapësirën më poshtë të krijoni një punim origjinal duke shprehur diçka që keni përjetuar dje. Mund të jetë diçka që keni bërë, thënë, dëgjuar, parë ose madje edhe ngrënë. Mund ta shprehni me vizatim, tregim, këngë ose çfarëdo formë tjetër arti që preferoni. Përdorni hapat në faqen 12 për t'ju udhëzuar në procesin e krijimit.

## Si fitojnë autorët të hollat me veprat e tyre?

Nuk munden të gjithë autorët të fitojnë të hollat me veprat e tyre. Krijimi i veprave artistike me kualitet që njerëzit tjerë do të blejnë kërkon kreativitet, talent, të holla dhe kohë. Për të krijuar, autorët kanë nevojë për të holla që të blejnë pajisjet e tyre dhe për të paguar për trajnim për të përmirësuar aftësitë e tyre. Gjithashtu, nëse e dedikojnë shumicën e kohës së tyre për krijimin e veprave, zakonisht nuk do të kenë kohë për punë tjetër. Për këtë, autorët duhet të jenë të paguar për punën e tyre për të paguar faturat e tyre.

Në të kaluarën, autorët e talentuar zakonisht kanë gjetur kohë dhe të holla për tu përqendruar në artin e tyre me ndihmën e patronëve. Këta



Pa marrë parasysh a kanë zbukuruar varreza për faraonë ose kanë kompozuar simfoni për perandorë, autorët kanë gjetur patronë për të sponsoruar veprat e tyre.

sponsorë kanë qenë njerëz të pasur dhe të fuqishëm, të cilët kanë kërkuar nga autorët të krijojnë vepra artistike për ta. Derisa sponsorimi i këtyre njerëzve të pasur u ka lejuar autorëve të talentuar të vazhdojnë me krijimtarinë e tyre, shumica e njerëzve nuk kanë pasur qasje me veprat e tyre.



Në ato ditë, veprat zakonisht kanë qenë unike, me vetëm një kopje për patronin i cili ka paguar për krijimin e tyre.

Me kohë, teknologjia shumë ka ndërruar situatën e autorëve duke e lehtësuar kopjimin e veprave të tyre nga njerëz tjerë. Më 1454, me shpikjen e makinës për shtypje të Gutenberg-ut u bë e mundshme të shtypen shumë kopje të veprave të shkruara për çmime të ultë. Kjo e bëri të mundshme që veprat e shkruara të jenë në disponim jo vetëm për të pasurit dhe të fuqishmit, por edhe për të gjithë njerëzit që mund të lexojnë. Prej atëherë, teknologji të reja kanë vazhduar të bëjnë veprat edhe më në disponim për të gjithë njerëzit. Mediet moderne si fotografia, radioja, TV-ja, CD-të, DVD-të,



kompjuterët dhe Interneti e bëjnë më të lehtë dhe më të lirë kopjimin dhe shpërndarjen të të gjitha llojeve të veprave tani, më shumë se kurdo në histori.

Makina moderne për shtypje ishte teknologjia e parë që ka ndikuar në mënyrën në të cilën autorët kontrollojnë riprodhimin dhe shpërndarjen e veprave të tyre.

Tani që veprat janë më të disponueshme për çdonjërin në tërë botën, autorët nuk mbështeten në sponsorët e pasur për të cilët duhet të krijojnë kopje unike të veprave të tyre. Për të nxjerrë bukën e gojës tani, autorëve u nevojitet kontroll mbi përdorimin e kopjeve të ndryshme të veprave të tyre. Pa këtë kontroll, ata nuk do të kishin mundur të fitojnë mjaft të holla për të jetuar nga arti i tyre dhe do të duhej të gjejnë punë tjera për të paguar faturat. Kjo do thotë më pak kohë për të krijuar veprime të reja dhe të gjithë ne do të ishim të prekur duke pasur më pak vepra me të cilat do të kënaqemi.


Për të inkurajuar dhe për të bërë të mundshme që autorët e talentuar të vazhdojnë të krijojnë, shumica e shteteve sot u japin të drejta të veçanta për të kontrolluar veprat e tyre. Kjo e drejtë është e njohur si e drejta e autorit.

# TË DREJTAT E AUTORIT

## Çfarë janë të drejtat e autorit?

*Njeriu pikturon me trurin e tij, jo me duart.* - Michelangelo

**Prona intelektuale** përfshin gjitha krijimet e trurit të njeriut. Prona intelektuale është e ndarë në **Të drejtat e autorit** dhe **Të drejtat e lidhura**, në njërën anë, dhe **Prona industriale** në anën tjetër.



Krijimet e trurit të njeriut mbrohen me ligjet e pronës intelektuale.

### Prona intelektuale

#### Të drejtat e autorit:

- Mbron veprat origjinale.

#### Të drejtat e lidhura:

- Mbrojnë performancat, incizimet origjinale dhe transmetimet e veprave.


#### Prona industriale:

- Patentat mbrojnë shpikjet.
- Dizajnet industriale mbrojnë dizajnet e produkteve.
- Shenjat dalluese mbrojnë shenjat përkatëse.

### Mendoni:

Ndonjëherë më tepër se një lloj prone intelektuale mund të përfshijë një produkt përkatës. Paramendoni, për shembull, frigoriferin. Shenja dalluese mund të mbrojnë emrin dhe logon e prodhuesit të frigoriferit. Pjesët dhe proceset e frigoriferit që e mbajnë ushqimin e ftohtë mund të jenë shpikje të patentuar. Dizajni i frigoriferit (stili dhe pamja e sirtarëve, rafteve, dorezave, etj) mund të mbrohet me dizajne industriale. Madje edhe manuali i përdorimit të frigoriferit teksti origjinal i shkruar është i mbrojtur me të drejta të autorit.

A mund të gjeni produkte tjera që mund të mbrohen me më tepër lloje të pronës intelektuale?





## Çfarë mbrojnë të drejtat e autorit?

Të drejtat e autorit mbrojnë shumë vepra, të cilat mund të jenë:



**Vepra të shkruara** - libra, fjalime, revista dhe artikuj në gazeta, romane, përralla, poema, ese, drama, tekste mësimore, ueb faqe, reklama dhe nota kërcimi.



**Vepra muzikore** - kompozime muzikore, tekste, këngë dhe tone celulare, në gjitha formatet (muzike në faqe, CD, MP3 skedarë, etj).



**Vepra artistike** - vizatime, piktura, fotografi, satira, skulptura, vepra arkitekturale dhe harta.



**Vepra dramatike dhe koreografike** - drama, opera dhe kërcime.



**Filma dhe produkte multimedia** - filma, video lojëra, TV programe dhe filma vizatimor.



**Programe kompjuterike** - gjuhë programimi kompjuterik njerëzor (kodi i burimit) dhe makinerik (kodi i synimit).

Të drejtat e autorit **NUK** mbrojnë ide ose fakte të thjeshta.

Të drejtat e autorit mbrojnë mënyrën në të cilën idetë janë shprehur. Kjo shprehje është unike në të cilën fjalët, notat muzikore, ngjyrat, format etj., zgjidhen dhe rregullohen. Shprehja është ajo që e bënë këtë funksionjë si origjinal. Kjo nënkupton që mund të ketë shumë vepra të ndryshme për idenë e njëjte dhe të gjitha do të mbrohen nga të drejtat e autorit, përderisa e shprehin këtë ide në mënyrë origjinale.

Për shembull, mësuesi mund të kërkojë nga ju dhe shokët e klasës të vizatoni një vizatim të qenit që luan me top. Ndonëse ideja (qeni me top) është e njëjtë, të gjithë ju do të zgjidhni ngjyrë të ndryshme dhe forma të ndryshme për të shprehur qenin dhe topin. Ndonëse vizatimet janë shprehje të idesë së njëjtë, ata do të jenë origjinal dhe me këtë të mbrojtura nga të drejtat e autorit.



Ideja (siç është qeni duke luajtur me top) mund të shprehet në shumë mënyra të ndryshme. Të drejtat e autorit mbrojnë shprehjen e idesë, jo vetë idenë.

### Mendoni:

A mund të gjeni ndonjë ide që është e shprehur në mënyrë të ndryshme nga tre vepra origjinale? Për fillim, keni këtë më poshtë

**Ideja:**  
Aventura e qenit.

**Vepra origjinale që shprehin atë ide:**  
*Thirrja e Egërsirës Romani* nga Jack London.  
Filmi *Betoven* nga Universal Studios.  
*Dog's Life PlayStation 2* lojë nga Frontier Developments.

---



---



---



---



---



---



---



---

## Autori i ri: Christopher Paolini

Christopher pëlqen shumë të lexojë aventura fantazi që në moshën 15 vjeçe vendosi të shkruajë përrallën e tij. I inspiruar nga ideja e një çuni që shikon një dragua që del nga veza (nga libri i Bruce Coville "Jeremy Thatcher, çelësi i draguave"), autori i ri shkroi një triologji fantastike për një çun, mikun e tij dragua dhe udhëtimet e rrezikshme për të shpëtuar botën nga e keqja. Christopher morri inspirim për përrallën e tij edhe nga veprat tjera me fantazi dhe fikcion shkencor, përfshirë edhe *Mbretin e Unazave* nga J.R.R. Tolkien, seriet *Dragonriders of Pern* nga Anne McCaffrey, dhe filmat e George Lucas "Star Wars". Ndonëse i inspiruar nga idetë që përdoren në vepra tjera, shprehja e këtyre ideve nga Christopher-i (përralla, përshkrimi, personazhet dhe dialogu) është origjinal dhe andaj të mbrojtura me të drejta të autorit. Kur Christopher mbushi 19, libri i tij i parë, *Eragon*, ishte bërë sukses, duke shitur miliona kopje në gjithë botën dhe duke marrë vendin në listën e veprave më të shitura të *Nju Jork Tajms*.


Përralla e Christopher-it, që ka marrë idetë nga romanet paraprake, tani ka inspiruar krijimin e veprave tjera origjinale: përkthime të librit në më shumë se 30 gjuhë, film, dhe video lojë



## Çfarë janë kushtet për të drejtat e autorit?

Në shumë raste, **origjinaliteti** është kushti i vetëm që vepra duhet të plotësojë për të qenë e mbrojtur me të drejta të autorit. Kjo nënkupton që vepra nuk mund të jete thjeshtë një kopje e ndonjë vepre tjetër.

Të drejtat e autorit mbrojnë veprat origjinale, pa dallim nga sasia e tyre.



Vepra nuk duhet të jetë e dobishme, e bukur ose e vlefshme për të qenë e mbrojtur me të drejta të autorit. Në fakt, veprat janë mbrojtur me të drejtat e autorit pa dallim nga sasia. Piktura me gisht e fëmijës ka njësoj të drejtë mbrojtjeje sikur edhe ndonjë kryevepër e piktorit të njohur. Kënga në reklama është njësoj e mbrojtur me të drejta sikur edhe hiti më i ri i grupit të preferuar. Shkresat origjinale në ditarin e juaj gjithashtu mund të mbrohen me të drejta të autorit sikur edhe vepra e fituesit të çmimit Nobel.



© Qeveria e Hong Kongut, Kinë. Të gjitha të drejtat e rezervuar.  
Falënderim special për Departamentin e Pronës Intelektuale në Hong Kong z. LEE Min-chi, dhe Jade Dynasty Grupit

Disa shtete kërkojnë që vepra të jetë e **rregulluar** në formë të prekshme para se të mbrohet. Vepra mund të rregullohet në mënyra të ndryshme, mund të shkruhet në letër, pikturohet në pëlhurë, incizohet (zë dhe/ose video), etj. Për shembull, në shtetet që kërkohet rregullim të veprës, koreografia e kërcimit mund të mbrohet vetëm kur lëvizjet janë të shkruara në nota kërcimi, incizuar në video pse e rregulluar në ndonjë formë tjetër.

### Si merren të drejtat e autorit?

Mbrojtja e të drejtave të autorit është automatike. Ne momentin që e vizatoni ndonjë pikturë ose shkruani ndonjë poemë, veprat e juaja mbrohen.

Simboli © zakonisht përdoret si shenjë që vepra është mbrojtur me të drejtat e autorit. Ky simbol shpeshherë shkon me emrin e pronarit të të drejtave dhe vitin që vepra ishte krijuar. Për shembull "© OBPI, 2007" do të përdoret për publikime që prodhohen nga OBPI në vitin 2007.

Në ueb faqet, pas simbolit © mund të shënohen më tepër se një vit, për shembull "© OBPI 1999-2007". Ky lloj i citimit zakonisht përdoret për veprat që vazhdimisht azhurnohen. Viti i parë është viti i publikimit të parë të veprës (vitin që është lansuar ueb faqja e OBPI) ndërsa viti i dytë është ose viti aktual ose viti i azhurnimit të fundit.

Meqë simboli © është vetëm përkujtim, nuk duhet të përfshini në veprat për t'i mbrojtur. Edhe nëse vepra nuk e përmban simbolin ©, ajo sërish mund të jetë e mbrojtur me të drejta të autorit.

### Mendoni:


Kthehuni në veprën që keni krijuar në faqen 13. Vendosni njoftim për të drejta te autorit me simbolin, © emrin dhe vitin në të cilin keni kompletuar veprën.

### Kush i posedon të drejtat e autorit?



Të drejtat e autorit të veprës specifike i posedon personi që ka krijuar atë vepër. Siç kuptuam më herët, krijuesi shpeshherë quhet me emrin autori i veprës. Për shembull, ju keni krijuar ditarin e juaj, projektin e artit dhe fotografitë nga pushimi i fundit. Ju jeni autori i cili i posedon të drejtat e autorit për gjitha këto vepra.

Ndonjëherë, veprat krijohen nga më shumë se një person. Në këtë rast, të gjithë tjerët që kanë kontribuar në krijimin e veprës konsiderohet si bashkë-autorë dhe ndajnë të drejtat e autorit të **veprës kolektive**.





Në disa raste, autorët preferojnë të mbeten anonim ose përdorin pseudonim për të fshehur identitetin e tyre të vërtetë nga publiku. Në këtë rast, autori ende i posedon të drejtat e autorit të veprës, ndonëse të drejtat e tij zakonisht menaxhohen nga kompania që përdor veprën (për shembull, publicisti i tij) për të mbajtur identitetin e tij mister.

### Mendoni:

Në 1967, gjashtëmbëdhjetë vjeçja Susan Eloise Hinton pashkruar "Të jashtmit" një roman për dy grupe rivali të adoleshentëve rebel. Përralla ishte shkruar nga këndvështrimi i çunit dhe publicisti i Susan ishte i brengosur që lexuesit nuk do të marrin librin me seriozitet nëse autori ishte vajzë. Libri ka fshehur identitetin e autorit duke përdorur inicialet e saja. S.E., në vend të emrit të saj të plotë.

- ◆ A mund të gjeni arsye tjera perse autorët ndonjëherë duan të fshehin gjithë ose pjesërisht identitetin duke mbetur anonim ose me pseudonim?
  - ◆ A mund të gjeni vepra nga autorë tjerë që kanë mbetur anonim ose kanë pseudonime?

Në disa shtete, kur një preson krijon vepër të re si pjesë e kontratës për punësim, kompania ose institucioni që e punëson mund të posedojë të drejtat e autorit mbi veprën.





## Kujdes !!

Nëse posedoni kopje elektronike ose fizike të veprës nuk ju bën pronar të përmbajtjes së mbrojtur. Për shembull, mund të posedoni librin por kjo nuk ju bën pronar të të drejtave të tekstit dhe pamjeve që gjendet në atë libër. Njësoj, blerja e CD-së nuk do të thotë që gjithashtu i keni blerë të drejtat e autorit për muzikën, tekstin dhe pamjet që gjenden në atë CD.

Meqë nuk i posedoni të drejtat e përmbajtjes në librat dhe CD-të që i keni, ka edhe kufizime të qarta se çfarë mundeni dhe nuk mundeni të bëni me këto produkte. Vazhdoni të lexoni për të zbuluar se çfarë të drejta janë të kufizuara nga pronarët e të drejtave të autorit.

## A janë të drejtat e autorit të njëjta në gjithë botën?

Të drejtat specifike që jepen autorëve nëpërmjet të drejtat e autorit varen nga ligjet kombëtare. Nga kjo, të drejtat e autorit në një shtet mund të mos jenë të njëjta sikur të drejtat në ndonjë shtet tjetër. Kjo mund të bëjë përdorimin e veprave me të ndërlikuar, veçanërisht në botë ku veprat mund lehtë të gjenden në shtete të ndryshme (për shembull, nëpërmjet internetit). Për të bërë më pak të ndërlikuar, qeveritë kanë firmosur marrëveshje ndërkombëtare që i zvogëlojnë dallimet në ligjet e tyre për të drejtat e autorit dhe bën përdorimin e veprave më të lehtë në botë.

Marrëveshja e parë që tentoi të zvogëlojë dallimet në të drejtat që jepen autorëve në shtete të ndryshme ishte **Konventa e Bernit**. Victor Hugo, autori i famshëm francez i *Les Misérables*, ishte përfshirë në krijimin e Konventës. Ai dhe autorët tjerë dëshironin që të sigurojnë se të drejtat e tyre respektohen në shtetet tjera njësoj sikur në shtetet e tyre amë.

Autori Victor Hugo ishte i përfshirë në krijimin e Konventës së Bernit.





Prej miratimit të Konventës së Bernit në vitin 1886, autoret kanë pasur një pako me të drejta të njëjta në më tepër se 160 vende që kanë firmosur Konventën (shtetet e saja anëtare).


Secili shtet anëtar i Konventës së Bernit duhet të ofrojë mbrojtjen e njëjtë të veprave të autorëve nga shtetet tjera anëtare sikur që ofron veprat e autorëve të saj kombëtar. Një përjashtim i kësaj rregulle është rregulla e afatit të shkurtë. Sipas kësaj rregulle, shteti anëtar nuk është i obliguar të ofrojë mbrojtje të veprave nga autori i huaj për më gjatë se koha e ofruar për mbrojtje të veprave nga shteti i origjinës së autorit.

Përveç kësaj, sipas Konventës së Bernit, veprat nuk duhet të jenë të regjistruar që të mbrojtjen me të drejta të autorit. Mbrojtja e të drejtave të autorit është automatike prej momentit që krijohet vepra.

### Mendoni:

A është vendi juaj shtet anëtarë (palë kontraktuese) e Konventës së Bernit? Mësojeni në lidhjen <http://www.wipo.int/treaties/en/ip/berne/>

Nëse po, veprat e juaj automatikisht mbrohen nga një pako minimale e të drejtave si në vendin e juaj ashtu edhe në vendet tjera që janë shtete anëtare të Konventës së Bernit.



### Organizata Botërore e Pronës Intelektuale (OBPI)

punon me zyrtar qeveritar të vendeve të ndryshme për të zhvilluar dhe azhurnuar marrëveshjet ndërkombëtare të të drejtave të autorit.

Nga selia në Gjenevë, Zvicër, OBPI-ja ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të autorit.

## Çfarë ofrojnë të drejtat e autorit?

Të drejtat e autorit ju ofrojnë autorëve një pako me të drejta ekskluzive mbi veprat e tyre. Me ekskluzive nënkuptohet që ka disa gjëra që autorët mund të bëjnë veprave të tyre. Në disa raste, autorët marrin të drejtë të kompensimit në vend të së drejtës ekskluzive. Në këto raste, autori mund të merr pagesë për përdorimin e veprës së tij, por nuk mund të ndalojë përdorimin vetë. Të dy, ekskluzive dhe kompensimi janë paramenduar si shpërblim të autorëve për kreativitetin e tij, investimin dhe punën dhe të nxisin të vazhdojnë të krijojnë vepra të reja.

Sipas Konventës së Bernit, ka dy lloje të të drejtave nën të drejtave të autorit:

**(1) Të drejtat ekonomike** - Autorët kanë të drejtë ekskluzive për të:

- a) **riprodhuar veprën.** Kjo përfshin çdo formë të kopjimit si fotokopjim, shkarkim, ngarkim, shtypje, incizim, fotografim, skanim, etj.
- b) **përkthyer** veprën në gjuhë tjera.
- c) **adaptojë veprën.** Ky ndryshim ose transformim zakonisht ndryshon llojin e veprës. Për shembull, adaptimi i romanit në film ose aminacion i vizatimit në film vizatimor. Shitja e personazheve (përdorimi i pamjeve të personazheve fiktive për të shitur produkte si fanella, lodra, etj.) mund gjithashtu të jete një formë adaptimi.
- d) **eksponuar/performuar** veprën në publik. Për shembull, shfaqja e pamjeve në galeri, performimi i dramës para publikut ose dëgjimi i CD-së në shitore ose restorant.
- e) **shpërndarje** të veprës duke shitur kopje publikut.


- f) **transmetojë** veprën. Për shembull, duke lëshuar këngën në radio ose lëshuar filmin në TV.
- g) **komunikuar** veprën para publikut. Për shembull, duke ngarkuar veprën në internet.

Në përfundim, asnjë vepër e mbrojtur nuk mund të riprodhohet, përkthehet, adaptohet, ekspozohet ose performohet në publik, të shpërndahet ose transmetohet ose komunikohet publikut pa lejen e autorit të saj. Kjo nënkuptohet me fjalinë, të gjitha të drejtat e rezervuar, që gjendet në shumë vepra.

### Kujdes !!

Ekzistojnë kufizime mbi të drejtat e autorit për shpërndarje që quhet edhe **doktrina e shkallës së parë**. Detajet specifike të kësaj rregulle varen nga ligjet vendase dhe mund të dallojnë prej shteti në shtet. Në përgjithësi, kjo rregull nënkuptim që e drejta e shpërndarjes për çdo kopje të veprës mbaron me shitjen e parë të asaj kopje. Kjo nënkupton që personi i cili blen kopjen e veprës ka të drejtë të shpërndajë atë kopje.

Për shembull, nëse blini muzikë në CD, mund të ofroni ndonjë miku si dhuratë, ose të e shitni në treg. Megjithatë, nuk mund të ngarkoni këngët e CD-së në internet sepse do të kërkohet që të bëni kopje elektronike të këngëve. Ndonëse mund të shpërndani një kopje specifike të veprës kur të blini njëherë, e drejta e riprodhimit sërish mbetet e drejtë ekskluzive e autorit.




**(2) Të drejtat morale** - Këto janë të drejtat që mirëmbajnë lidhje personale mes autorëve dhe veprave të tyre. Kjo përfshin të drejtën:

- a) e njohjes si autori i veprës (e drejta e maternitetit). Kjo nënkupton që autorët mund të zgjedhin të shënojnë emrin e tyre, mos të shënojnë emrin e tyre (të mbeten anonim) ose të shënojnë emër fiktiv (të përdorin pseudonim) në veprat e tyre.
- b) e reagimit të çfarëdo ndryshimeve të veprës, që mund të dëmtojnë nderin ose reputacionin e autorit (e drejta e integritetit).

### Sa është kohëzgjatja e të drejtave të autorit?

Mbrojtja me të drejtat e autorit nuk zgjat përgjithmonë. Kohëzgjatja e mbrojtjes varet nga:

- ◆ ligjet vendase të secilit shtet;
- ◆ kush ka krijuar veprën;
- ◆ lloji i veprës.



Vendet që janë anëtare të Konventës së Bernit, e drejta e autorit zgjat për gjithë jetën e autorit plus 50 vite pas vdekjes së tij. Megjithatë, në shumë vende, mbrojtja e të drejtave të autorit zgjat më shumë se kjo periudhë minimale. Për shembull, në SHBA dhe shtetet e Bashkimit Evropian, mbrojtja e të drejtave të autorit zakonisht zgjasin për gjithë jetën e autorit plus 70 vite pas vdekjes së tij.

Të drejtat ekonomike transferohen tek trashëguesi i autorit pasi të vdes ai. Ata bëhen bartësit e të drejtave të veprave të autorit të vdekur. Këto **bartës të të drejtave** vazhdojnë të marrin pagesën për riprodhim, përkthim, adaptim, performancë publike, shpërndarje, transmetim dhe komunikim para publikut të veprës megjithatë mbrojtja e të drejtave të autorit zgjat pas vdekjes së autorit.

## The BOY WHO WOULD NEVER GROW UP



Për shembull, para vdekjes së tij në vitin 1937, autori skocez J.M.

Barrie i dha të drejtat e autorit për romanin e tij Peter Pan si dhuratë Spitalit të Londrës. Ky spital, tani i ka të drejtat e Peter Pan dhe ka të drejtë të ndalojë/lejojë dhe bëjë pagesën për çdo performancë, adaptim dhe publikim të përrallës së Peter Panit.

Të drejtat morale zakonisht zgjasin njëson sikur të drejtat ekonomike, ndonëse në disa vende, zgjasin përgjithmonë. Varësisht nga ligjet vendore, të drejtat morale mund gjithashtu ndonjëherë të transferohen në trashëgimtarët e autorit, të cilët sigurojnë që autori i vdekur do të njihet si autori i veprës së tij dhe që nderi dhe reputacioni nuk do të dëmtohen nga ndryshimet e veprës.

Në rastet kur vepra është krijuar nga më shumë se një autor, fundi i të drejtës të autorit kalkullohet nga koha e vdekjes së bashkë-autorit të fundit që ka jetuar. Për shembull, autorët francez René Goscinny dhe Albert Uderzo bashkë kanë krijuar revistat Asteriks. René Goscinny vdiq në vitin 1977 por të drejtat e autorit kolektiv të veprës do të skadojë vetëm 70 vite pas vdekjes së Albert Uderzo, bashkë-autori i fundit që jeton.

Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprave anonime dhe pseudonimeve është kalkuluar nga koha që janë publikuar. Megjithatë, nëse identiteti i vërtetë i autorit njihet edhe me pseudonimin, atëherë mbrojta e të drejtave të autorit kanë kohëzgjatjen e njëjtë sikur edhe për autorët e njohur (deri 50 vite pas vdekjes së tij).

Kur autori i veprës është korporatë ose institucion, e jo individ, kohëzgjatja e të drejtave të autorit gjithashtu kalkullohet nga koha që është publikuar vepra.

Së fundi, në shumë vende, filmat dhe fotografitë kanë periudha të ndryshme (zakonisht më të shkurtë) të mbrojtjet sesa veprat.


## Mendoni:

Sa është kohëzgjatja e mbrojtjes së të drejtave të autorit në vendin e juaj? A varet ajo se kush ka krijuar veprën dhe çfarë lloji vepre bëhet fjalë?

Mund të gjeni përgjigje të këtyre pyetjeve duke kontaktuar zyrën vendore për të drejtat e autorit ose duke lexuar ligjet për të drejtat e autorit. Një vend ku mund të gjeni informacione në lidhje me ligjet e të drejtave të autorit për vendin e juaj është baza me të dhëna KLQE (Koleksioni i Ligjeve për Qasje Elektronike e

OBPI-së:

<http://www.wipo.int/clea/en/index.jsp>



## A mund të transferohen të drejtat e autorit?

Autorët mund të vendosin të shesin të drejtat e tyre ekonomike të veprave. Me shitjen e të drejtave, autorët mund të koncentrohen në krijimin veprave të reja derisa tjerë merren me riprodhimin, përkthimin, adaptimin dhe shpërndarjen e veprës së tij të vjetër. Ata që blejnë të drejtat ekonomike të autorëve gjithashtu quhen edhe bartës të të drejtave.

Të drejtat morale janë të pavarura nga ato ekonomike dhe çdoherë mbeten me autorin, madje edhe kur shiten të drejtat ekonomike.

Autorët që shesin të drejtat ekonomike të veprave marrin pagesa që quhen **mbretëri**. Ekzistojnë dy mënyra të shitjes së të drejtave ekonomike: **detyrime** dhe **licenca**.

Detyrimi është një mënyrë e transferimit të një ose më tepër të drejta ekonomike të autorit që personi i cili i blen të drejtat bëhen pronari i ri i të drejtave të autorit. Jo gjithë vendet lejojnë detyrime.

Licencimi nënkupton që autori mbetet pronari i të drejtave të tij ekonomike por e lejon blerësin (ose të licencuarin) të zhvillojë disa veprime të mbuluara me këto të drejta për një kohë të caktuar dhe qëllim



specifik. Për shembull, autori i romanit mund të licencoje të drejtat e riprodhimit dhe shpërndarjes publicistit. Ai mund të licencojë të drejtat edhe për adaptim ndonjë procenti të filmit që dëshiron të bëjë film në bazë të romanit.

Në fund, një autor mund të vendos që mos të përdor disa ose gjitha të drejtat e tij. Për shembull, mund të ngarkojë veprën e tij në internet dhe të theksojë që secili mund të përdor falas. Ai mund edhe të kufizojë përdorimin e veprës që ka ngarkuar, për shembull, duke lejuar që vepra të përdoret vetëm për qëllim jokomerciale. Në këtë rast, ai do të lejojë tjerëve të kopjojnë, përkthejnë, adaptojnë madje edhe të transmetojnë veprën për derisa nuk fitojnë para nga këto përdorime.

Organizatat si Creative Commons ofrojnë shembuj si autorët mund të etiketojnë veprat e tyre që të jetë qartë se cilat të drejta vlejnë. Më tepër informata mund te gjeni për këtë në: can find more information about this at: <http://creativecommons.org/>

### Autori i ri: Flavia Bujor

Në moshën dymbëdhjetë, Flavia filloi të shkruajë një përrallë për tre vajza të reja që dëshirojnë të shpëtojnë botën e tyre të fantazisë me ndihmën e gurëve magjik. Dy vite më vonë, libri i saj Parashikimi i gurëve (La prophétie des pierres), ishte publikuar në Francë. Libri ishte një sukses i madh dhe më shumë se 20 publicistë komercial në gjithë botën nxituan të blejnë të drejtat për përkthim, publikim dhe shitje të librit të Flavia-s në vendet e tyre.

Romani i saj ishte shitur në dhjetëra mijëra kopje në Francë, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara.

Flavia shiti të drejta për përkthim, riprodhim, shpërndarje të librit të saj.



Falënderim prej: Hyperion Books for Children



## Lojë: Detektivi i të drejtave të autorit\*

Shikoni mirë kopertinën dhe faqen e brendshme të librit fiktiv më poshtë dhe gjeni:

Kush posedon të drejtat morale të origjinalit. Teksti në gjuhën portugeze?

Kush posedon të drejtat morale të tekstit të përkthimit në gjuhën angleze?

Kush posedon të drejtat e autorit të dizajnit të kopertinës?

Kush posedon të drejtat e publikimit?

Cilat janë të drejtat ekonomike të përfshira në referencën të gjitha të drejtat e rezervuar.



### AMAZON Ëndrra nga A. Chico

Përkthyer nga gjuha origjinale  
portugeze nga: J. Little

Dizajni i kopeertinës:  
Carlos Mayorga  
©2006 XYZ Publikues  
Të gjitha të drejtat e  
rezervuar

\* Shikoni faqen 58 për përgjigjet



## Çfarë janë të drejtat e lidhura?

Veprat artistike zakonisht bëhet të gatshme për publikun nëpërmjet shërbimeve të performuesve, producentëve të fonogrameve dhe transmetuesve. Mendoni, për shembull, për një këngë që lëshohet në radio. Kur autorët (tekst shkruesi dhe kompozitori i muzikës) e krijojnë këngën, atëherë ajo performohet nga këngëtarë dhe muzikantë, të incizuar nga producent i fonogrameve dhe përhapur nga transmetuesi.

Performimi, incizimi dhe transmetimi i veprave kërkon një investim të madhe të kohës dhe parave. Për të mundur kthim të investimit dhe nxitje të më shumë veprave të bëhen të gatshme për publikun, qeveritë japin të drejta speciale performuesit, producentëve të fonogrameve dhe transmetuesve. Këto të drejta quhen të drejta e lidhura sepse ata janë ngushtë të lidhura me të drejtat e autorit.

Kohëzgjatja e të drejtave e lidhura varet nga ligjet vendore të secilit shtet. Në përgjithësi, mbrojtja minimale zgjat: për performues, 50 vite nga fundi i vitit në të cilën performanca është caktuar në një fonogram; për producentët e fonogrameve, 50 vite nga fundi i vitit në të cilin fonogrami publikohet dhe për transmetuesit, 20 vite nga fundi i vitit në të cilin zhvillohet transmetimi.

### Performues

Shumë vepra artistike nuk do të vlerësoheshin tërësisht pa ndihmën e Performuesve. Për shembull, përbërja muzikore zakonisht preferohet kur zhvillohet nga muzikant sesa të lexohet në faqe muzikore. E njëjta vlen edhe për shkresa, drama, madje edhe romane, që shumë njerëz preferojnë kur ata janë të performuar nga aktorë në skenë ose video xhirime.



Performuesit, si aktorët, muzikantët, kërcyesit dhe këngëtarët sjellin jetë veprave të autorëve. Me aktrimin e tyre, luajtja e instrumentit, kërcimi ose këndimi, performuesit interpretojnë veprat në stilin e tyre unik. Interpretimet origjinale të veprave janë të vlefshme dhe prandaj të mbrojtura me të drejtat e lidhura.

Në përgjithësi, performuesit mund të ndalojnë incizimin dhe transmetimin e performancave të tyre live pa pajtimin e tyre. Ata kanë të drejtë të ndalojnë, mes tjerash, kopjimin e mëtutjeshëm dhe transmetimin me internet të muzikës së tyre. Për shembull, një grup mund të ndalojë fansat të mos të incizojnë performancën e tyre. Ata mund gjithashtu të ndalojnë fansat të vendosin albumet e grupit të tyre në internet.

Pa këto të drejta, performuesit nuk do të paguheshin për interpretimet e tyre. Nëse dikush mund të incizojë dhe të transmetojë lirshëm performancën e artistëve pastaj ata njerëz do të paguanin për biletën të marrin pjesë në performancën do të preferonin të shikojnë transmetim falas. Incizimet e kopjuar pa pajtimin e artistit gjithashtu nuk gjenerojnë të ardhura as për artistin. Nëse artisti nuk mund të fitojë nga interpretimet, ai duhet të punojë diçka tjetër për të fituar të holla dhe do të performojë dhe incizojë më pak vepra që neve si publik të kënaqemi.


Në disa vende, performuesit kanë gjithashtu të drejta të ngjashme sikur të drejtat morale të autorit. Këto të drejta mbrojnë performuesit kundër prishjes së performancës së tyre. Ajo gjithashtu mundëson që të kërkojnë emrat e tyre të përmenden në lidhje me performancën e tyre.



## Autori i ri: Athena Adamopoulos

Që prej kur mban mend, Athena ka kompozuar muzikë në kokën e saj. Ajo luan çelo dhe piano dhe preferon të kompozojë vepra origjinale për dy instrumentet. Kur behet fjalë për performimin e veprave të saja, megjithëse, ajo preferon të ulet dhe te lejojë muzikantët e talentuar të luajnë veprat e saja. Në fakt, ishte performanca e një prej kompozimeve të Athena-s, *Soliloquy*, nga çelistja me famë botërore Yo Yo Ma në radio transmetim, që i bëri Athena-s më tepër publicitet dhe respekt si kompozitore e re. Athena ëndërron që një ditë të dëgjojë kompozimet e saja si pjesë e ndonjë muzike kryesore të filmave.

"Kur e dëgjova veprën time në kokë fillimisht, e dëgjova paksa të ngjashëm me këtë por jo saktë...dhe kjo është dhjetë here më e mirë"- reagimi i Athena-s pas dëgjimit të Yo Yo Ma duke performuar veprën e saj.



Fajënderim prej:  
Athena Adamopoulos

## Prodhuesi i regjistrimeve fonografike



Prodhuesi i regjistrimeve fonografike është personi ose kompania që të parët e rregullojnë (incizojnë zërin e) performancës. Fonogrami është incizimi origjinal, ndërsa CD ose MP3 skedarët janë kopje të këtij origjinali.

Për incizimin e zërit të performancës duhet pajisje e shtrenjtë teknike dhe punonjës të specializuar. Prodhuesit e regjistrimeve fonografike rikthejnë kostot e kësaj pajisje dhe punës duke shitur kopje të fonogrameve në CD ose MP3 skedarë. Prodhuesit e regjistrimeve fonografike kanë të drejtë të autorizojnë ose ndalojnë tjerët të mos kopjojnë, transmetojnë dhe shpërndajnë fonogramet e tyre.

Ndonëse është vështirë dhe shtrenjtë të prodhohet incizimi i parë cilësor i performancës, teknologjia e re e ka bërë më të lirë dhe më të lehtë kopjimin e incizimit origjinal. Nëse prodhuesit e regjistrimeve fonografike nuk do të kishin të drejtë të ndalojnë tjerët të riprodhojnë fonogramet e tyre, shumë njerëz do të kopjonin falas në vend që të blejnë CD-të ose MP3 skedarët që prodhuesit e regjistrimeve fonografike i kanë për shitje. Ky kopjim i pakontrolluar nuk do të sillte të ardhura prodhuesve të regjistrimeve fonografike që nga ana tjetër nuk do të mundeshin të mbulojnë kostot e bëra për incizimin e performancës origjinale. Nëse prodhuesit e regjistrimeve fonografike nuk fitojnë të holla nga incizimet e tyre origjinale, ata nuk do të kenë nxitje të mjaftueshme për të vazhduar në të ardhmen performanca tjera. Si rezultat, më pak autorë dhe performues do të kenë mundësinë që të incizojnë veprat e tyre. Përveç kësaj, konsumatorët do të kenë më pak zgjidhje të muzikës së re për të dëgjuar.

Në shumë incizime të zërit, (P) simboli përdoret për të identifikuar pronarin e të drejtave e lidhura për incizimin.

### Organizata transmetimi



Transmetimet në radio dhe TV stacione bëjnë veprat e autorëve dhe interpretimet e tyre nga performuesit më të kapshme për publikun e gjere. Për të inkurajuar organizatat e transmetimit të investojnë në teknologjinë e nevojshme për të transmetuar vepra, qeveritë gjithashtu japin mbrojtje të të drejtave e lidhura këtyre organizatave.

Organizatave transmetuese kanë të drejtë të autorizojnë ose ndalojnë ri-transmetimin, incizimin dhe kopjimin e incizimit e transmetimeve të tyre.

## Aktivitet për krijimtari

Me një grup miq, zgjidhni:

Krijoni, performoni dhe incizoni live video muzikë:

- 1) shkruani tekstin e këngës, kompozoni muzikën, koreografoni kërcimin;
- 2) zgjidhni muzicentët, këngëtarët dhe kërcimtarët për të performuar;
- 3) zgjidhni një vend për të performuar muzikën;
- 4) dizajmoni afishe për të promovuar performancën;
- 5) performoni këngën dhe incizoni performancën e juaj.

ose

Krijoni, performoni dhe incizoni një skeç:

- 1) shkruani skenarin e skeçit për të performuar, përfshirë edhe drejtimet në skenë dhe dialogun;
- 2) zgjidhni aktorët dhe caktoni një regjisor për të ndihmuar në provat;
- 3) zgjidhni një vend për të performuar skeçin;
- 4) dizajmoni afishe për të promovuar performancën;
- 5) aktrojeni skeçin dhe incizojeni performancën.

Pastaj konsiderojeni:

- 1) Çfarë të drejta autori/ose të drejta e lidhura ka secili prej anëtarëve të ekipit mbi veprën kolektive dhe performancën?
- 2) Sa kohë dhe të holla keni harxhuar për të krijuar dhe performuar videon muzikor/skeçin?
- 3) Çfarë doni të bëni me veprën përfundimtare? (për shembull: tregojani produksioneve muzikore që të merrni kontratë për incizim; bëjeni të gatshme fals për shkarkim në internet; të shitini kopje vetë, etj)

## Si menaxhohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura?

Para se ju ose ndokush tjetër të përdorni veprën e mbrojtur me të drejta të autorit dhe/ose të drejta të lidhura, duhet të gjeni bartësit për të kërkuar leje dhe ndonjëherë të paguar për të drejtat e përdorimit të veprës. Ky proces quhet e **drejtë nisjeje**.

Autorët dhe performuesit (veçanërisht ata të famshëm) shpejtë mbulohen me kërkesa nga njerëzit që dëshirojnë të riprodhojnë, transmetojnë, adaptojnë ose në mënyrë tjetër të përdorin veprat dhe performancat e tyre me kërkimin e lejes së tyre. Evidentimi i gjitha këtyre kërkesave dhe vendosja nëse të jepet ose jo leje fals ose për ndonjë shumë, mund të jetë mjaft e mundshme.

Këto kërkesa janë të rëndësishme sepse me dhënien e lejes nëpërmjet licencave dhe detyrimeve autorët dhe performuesit marrin pagesat e tyre mbretërore. Për të pasur kohë që të vazhdohet me krijimtarinë dhe performancën derisa duke i rregulluar gjitha kërkesat, shumë autorë dhe performues mbështeten në shërbimet e **Agjencive të Administrimit Kolektiv**. Këto organizata veprojnë si lidhje mes autorëve dhe performuese dhe ata që dëshirojnë të përdorin veprat e tyre. Ata japin autorizime, mbledhin pagesat mbretërore, dhe zbulojnë dhe kërkojnë kompensim për përdorimet e paautorizuar. Falë këtyre organizatave, autorët dhe performuesit marrin pagesën që meritojnë kur veprat e tyre dhe performancat përdoren, dhe përdoruesit mundën më lehtë të marrin leje për përdorimin e veprave dhe performancave të tilla.

Shumë vende kanë agjencitë e administrimit kolektiv që mund të kontaktoni për të menaxhuar të drejtat e veprës ose performancës së juaj. Gjithashtu, mund të kontaktoni këto organizata kur keni nevojë për përdorimin e veprave ose performancave të autorëve tjerë.



Agjencitë e administrimit kolektiv zakonisht i takojnë ndonjë shoqate ndërkombëtare (grup) të këtyre organizatave. Për të gjetur organizatat vendore që mund t'ju ndihmojnë në menaxhimin e të drejtave si autor, ose udhëzojë si të merrni leje të përdorni veprën e ndokujt tjetër ose performancën, duhet të kontaktoni shoqatën e tillë ndërkombëtare.


Më poshtë gjenden internet lidhjet të disa prej shoqatave të njohura ndërkombëtare që ndihmojnë autorët, performuesit, prodhuesit e regjistrimeve fonografike dhe organizatat transmetuese për të zbatuar të drejtat e tyre:

- ◆ Shoqata e Organizatave Evropiane të Performuesve  
<http://www.aepo.org>
- ◆ Konfederata Ndërkombëtare e Shoqatave të Autorëve dhe Kompozitorëve  
<http://www.cisac.org>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Aktorëve  
<http://www.fia-actors.com>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Muzicientëve  
<http://www.fim-musicians.com/eng/index.html>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Organizatave për të Drejtat e Riprodhimit  
<http://www.ifrro.org>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Industrisë Fonografike  
<http://www.ifpi.org/>

## Lojë: Caktoni të drejtat\*

Shikoni mirë kopertinën dhe detajet e këngëve të CD-së muzikore fiktive më poshtë. Caktoni se çfarë lejesh ju nevojiten për të:

- ◆ Kënduar Indigo këngën në performancën vijuese publike të grupit tuaj.
- ◆ Ngarkuar këngë nga albumi në internet faqen e juaj.
- ◆ Riprodhuar pikturën e kopertinës në fanellë.
- ◆ Transmetuar Indigo këngën në radio stacionin lokal.
- ◆ Incizuar melodinë e Indigo këngës për të përdorur si muzikë prapavije në filmin që jeni duke punuar.
- ◆ Përdorur tekstin e refrenit të Indigo këngës si pjesë të këngës që jeni duke kompozuar.



\* Shikoni faqen 59 për përgjigjet.

# DOMENI PUBLIK DHE KUFIZIMET E TË DREJTAVE TË AUTORIT


Ligjet e të drejtave të autorit tentojnë të gjejnë baraspeshë mes të drejtave që japin autorëve dhe të drejtave të qasjes publike dhe përdorimit të veprave. Madje edhe autorët përfitojnë nga mundësia për qasje dhe përdorim të autorëve paraprak që i inspirojnë dhe ndihmojnë mësojnë teknika që mund të përdorin për të zhvilluar vepra të reja. **Domeni publik** dhe të drejtat e autorit ofrojnë këtë baraspeshë mes të drejtave të autorit dhe të drejtave të publikut.

## Çfarë është domeni publik?

Domeni publik përbëhet nga të gjitha veprat që nuk janë të mbrojtura me të drejta të autorit dhe janë të lira për përdorim pa leje nga ose pagesë për autorin origjinal. Kjo nënkupton që veprat e domenit publik mund lirshëm të kopjohen, shpërndahen, adaptohen, performohen dhe shfaqen në publik sikur të jenë në pronë të publikut.

Veprat kalojnë në domenin publik kur:

- ◆ **Të drejtat e tyre të autorit skadojnë.** Siç përmendëm më lartë, termi e drejta e autorit dallon prej vendi në vend por zakonisht skadon pas 50 deri 70 viteve pas vdekjes së autorit.
- ◆ **Nuk kualifikohen për mbrojtje të të drejtave të autorit.** Faktet dhe listat nuk kualifikohen për mbrojtje të të drejtave të autorit, andaj listat e përbërësve të recetave dhe datat në kalendar janë në



Pamje e domenit publik të Saturnit që gjendet në galerinë e NASA-s.



domenin publik. Megjithatë, përshkrimi si të përdoren përbërësit e recetës dhe dizajni që është përfshirë në kalendarin mund të konsiderohen si shprehje origjinale andaj janë të mbrojtura me të drejta të autorit. Më tutje, në disa vende, dokumentet qeveritare gjithashtu nuk kualifikohen për mbrojtje të të drejtave. Për shembull, Administrata Kombëtare e Aeronautikës dhe Gjithësisë (NASA) është agjenci qeveritare e Shteteve të Bashkuara që prodhon shumë pamje dhe video që nuk kualifikohen për mbrojtje dhe prandaj janë të domenit publik. Mund të gjeni veprat e domenit publik të NASA-së në lidhjen: <http://www.nasa.gov/multimedia/imagegallery/index.html>

## Kujdes !!

Veprat që nuk shtypen ose nuk janë më në shitje nuk do të thotë që janë në domenin publik. Nëse të drejtat e autorit ende nuk kanë skaduar, sërish duhet të merret leje nga bartësit e të drejtave para se të kopjohet, shtypet, shpërndalet ose përdoret në mënyrë tjetër.

## Si mund të përdoren veprat e domenit publik?

Veprat në domenin publik mund të përdoren sipas dëshirës nga secili. Merrni për shembull, pikturën *The Scream* të artistit norvegjez Edvard Munch. Që prej hyrjes në domenin publik, kjo pikturë është riprodhuar në afishe, libra arti, kukulla, zinxhirë, filma vizatimor dhe shumë produkte tjera. Bizneset e ndryshme që shesin këto produkte nuk kanë qenë të obliguar të blejnë të drejtat për përdorimin komercial të kësaj vepre të domenit publik.



Falënderim prej: Associated Press



Veprat e domenit publik si ajo e Munch-it *The Scream*, mund lirshëm të kopjohet, adaptohet dhe shpërndalet nga secili.


## Kujdes !!

Veprat në domenin publik zakonisht përdoren nga autorë të ndryshëm për të krijuar vepra të reja. Kur vepra origjinale përkthehet, adaptohet ose ndryshohet në formë tjetër, vepra e re quhet **vepër derivate**. Vepra derivate janë gjithashtu të mbrojtura me të drejta të autorit, edhe nëse vepra origjinale nga e cila është bërë derivati janë në domenin publik. Personi që ka krijuar veprën derivate është autori i saj dhe posedon të drejtat e autorit. Secili që dëshiron të përdor (riprodhojë, përkthejë, adaptojë etj.) veprën derivate që është mbrojtur me të drejta të autorit duhet të merr leje paraprake nga autori i veprës derivate.

Kur kërkohen vepra të domenit publik për përdorim si pjesë e krijimeve të juaja të reja, siguroni që versioni që jeni duke përdorur është origjinali, versioni i domenit publik dhe që vepra derivat ende mund të jetë e mbrojtur nga të drejtat e autorit.

Për shembull, teksti origjinal i Lewis Carroll dhe vizatimet nga John Tenniel për librin *Aventurat e Alisës në Botën e Çudirave* e publikuar në 1865, janë në domenin publik dhe lehtë mund të përdoren nga secili. Mirëpo, filmi, vizatimet, personazhet e filmave, mallrat, etj., të krijuar nga Walt Disney në 1951, që janë adaptim i Alisës origjinale të Carroll, ende janë të mbrojtura me të drejta të autorit dhe nuk mund të përdoren pa lejen e The Walt Disney Company. Gjithashtu, fotografia e Alisës e dhënë më poshtë është regjistruar si shenjë dalluese dhe kjo e ndalon të hyje në domenin publik, madje edhe kur të skadojë e drejta e autorit.

Vizatimet origjinale të Alisës nga John Tenniel tani janë në domenin publik, por vizatimet e adaptuara nga Walt Disney janë ende e drejtë e autorit dhe shenjë dalluese.







Kompozimet origjinale të Shopenit janë në domenin publik, por incizimet e fundit të këtyre kompozimeve mund të jenë mbrojtur me të drejtat e lidhura.

Kur kërkoni ndonjë vepër në domenin publik, mos i harroni të drejtat e lidhura. Për shembull, ndonëse veprat e muzikës klasike siç është ajo e krijuar nga Shopen tani janë në domenin publik, performancat e fundit dhe incizimet e këtyre kompozimeve mund ende të mbrohen me të drejtat e lidhura. Kjo nënkupton që mund të përdorni kompozimin origjinal duke e lëshuar në recital publik ose duke inkorporuar pjesë të saj në këngën që jeni duke krijuar. Mirëpo, nuk mund të kopjoni, shpërndani, transmetoni ose të përdorni në mënyrë tjetër incizimet e këtij kompozimi që ende janë të mbrojtura me të drejtat e lidhura.

### Performuesi i ri: Evgeny Kissin

Pianisti me famë botërore Evgeny filloi të bie pianos kur ishte vetëm dy vite. Në moshën 12 ai performoi koncertet me piano të Shopenit 1 dhe 2 me Orkestrën Filharmonike të Moskës dhe u ngrit në yje.

Që prej atëherë, Evgeny ka zhvilluar koncerte në gjithë botën, ka bërë shumë incizime dhe ka fituar shumë çmime.

Muzikën që ai bën është zakonisht nga kompozitorë si Shopen, Mocart, Betoven, Çajkovski dhe Shuman, të cilët i kanë veprat në domenin publik. Interpretimet e Evgeny të këtyre veprave, megjithatë, janë të mbrojtura me të drejta të autorit. Falë këtyre të drejtave, Evgeny mund të fitojë të holla për veten dhe familjen nga koncertet dhe incizimet.

Evgeny Kissin ka fituar të holla duke performuar vepra që janë në domenin publik



(Meritat: Sheila Rock)  
Falënderim prej SONY/BMG

## Lojë: Kërkim pasurie në domenin publik\*

Në Bashkimin Evropian të drejtat e autorit për letërsi skadojnë 70 vite pas vdekjes së autorit. Më poshtë kemi një listë të veprave të njohura letrare nga autorë evropian. A mund të gjeni katër veprat që nuk janë ende në domenin publik?



nga Jules Verne  
(1827-1905)



nga Carlo Collodi  
(1826-1890)



nga Hergé  
(1907-1983)



nga Roald Dahl  
(1916-1990)



nga Miguel de Cervantes  
(1547-1617)



nga C. S. Lewis  
(1898-1963)




nga Hans Christian Andersen  
(1805-1875)




nga Astrid Lindgren  
(1907-2002)



nga Alexandre Dumas  
(1802-1870)



nga Emilio Salgari  
(1862-1911)



nga Robert Louis Stevenson  
(1850-1894)



## Ku mund të gjenden veprat e domenit publik?

Si rregull e përgjithshme, shumë prej veprave që konsiderohen si klasike ose tradicionale janë mjaft të vjetra për të qenë në domenin publik. Megjithatë, të kërkonti vepra më të reja që gjenden në domenin publik nuk është lehtë. Siç treguam më herët, ndihmon shumë nëse i ndiqni këto hapa gjatë kërkimit të veprave nga domeni publik:

- 1) Mësoni specifikat e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura në vend: sa zgjasin për secilin lloj të veprës dhe cilat vepra nuk kualifikohen për mbrojtje. Për veprat që nuk janë krijuar në vendin e juaj, zbuloni nëse vendi i juaj ose vendi në të cilën veprat janë krijuar janë anëtare të Konventës së Bernit. Gjithashtu, kontrolloni nëse vendi juaj ndjek rregullën e afatit të shkurtë, që do t'ju ndihmojë të vendosni nëse vepra është më vetëm në domenin publik në vendin që është krijuar a është edhe në domenin publik në vendin e juaj.
- 2) Mësoni qartë nëse vepra që dëshironi të përdorni është vepra origjinale ose vepër derivat, që mund të ketë mbrojtje plotësuese të autorit ose të drejta të lidhura.
- 3) Kontrolloni njoftimin për të drejtat e autorit dhe kushtet e përdorimit që gjendet në veprën. Ky njoftim ndihmon në identifikimin e bartësit të të drejtave dhe llojet e të drejtave të rezervuar. Ky hap është veçanërisht i rëndësishëm kur kërkonti vepra në internet.

### Kujdes !!

Nëse veprat janë të gatshme në internet, nuk do të thotë që është në domenin publik dhe e gatshme për përdorim nga secili. Çdoherë lexoni termet e përdorimit në ueb faqet para se të bëni kopje, shpërndani ose përdorni ndryshme atë që gjeni në internet.

- 4) Kontrolloni nëse vepra është e mbrojtur nga ndonjë lloj tjetër të pronës intelektuale, si shenja dalluese (zakonisht mbajnë simbolet ® ose TM).

Nëse pas gjitha këtyre kontrollimeve ende nuk jeni të sigurt nëse vepra gjendet ose jo në domenin publik, më mirë është të kërkonti leje para se të filloni të përdorni. Shembulli i letrës për kërkimin e lejes në faqen 65 ju jep një pasqyrë si të kërkonti lejen e tillë.

### Çfarë janë kufizimet e të drejtave të autorit?

Ligjet vendore mundësojnë që veprat e mbrojtura me të drejtë autori dhe të drejtë lidhëse të përdoren lirshëm në situata speciale. Në raste tjera, ligjet vendore lejojnë veprat të përdoren pa mos pyetur bartësin e të drejtave për leje përderisa është i kompensuar për këtë përdorim. Falë këtyre kufizimeve të të drejtave, madje veprat që nuk janë në domenin publik ndonjëherë mund të përdoren pa kërkimin e lejes ose pagesës së shumëmbretërore autorit ose bartësit e të drejtave. Megjithatë, duhet dhënë meritat përkatëse autorit, performuesit, prodhuesit të regjistrave fonografike dhe transmetuesit për veprën duke i përmendur emrat e tyre dhe duke dhënë burimin e veprës.

Për shembull, përdorimi i lirë vlen kur veprat përdoren në:

- ◆ Citate
- ◆ Mësimdhënie
- ◆ Raportimi i lajmeve

Përveç kësaj, disa ligje vendore lejojnë kopjimin e veprës ekskluzivisht për përdorim personal, privat dhe jokomercial. Kjo nënkupton që mundeni, për shembull, të printoni një pamje të mbrojtur nga interneti, të vendosni në mirin e juaj për kënaqësi të juaj personale, por nuk mund të përdorni pamjen e njëjtë për të prodhuar fanella dhe të shitni (përdorim komercial).

Internet faqet e dhëna më poshtë mund t'ju ndihmojnë të gjeni veprat që janë në domenin publik ose të janë të gatshme për përdorim të kufizuar falas. Megjithatë, kini kujdes sepse informacionet në këto faqe janë vetëm indikatorëve dhe nuk ofrojnë shqyrtim përfundimtar të statusit ligjor të veprave në vendin e juaj. Gjithashtu, para se të përdorni ndonjë prej veprave nga faqet, mos harroni të kontrolloni seksionin e Termeve për Përdorim.

### Fotografi

- ◆ Big Foto

<http://www.bigfoto.com>

- ◆ morgueFile

<http://morguefile.com>

- ◆ Pics4learning

<http://www.pics4learning.com>

### Letërsi

- ◆ The Online Books Page

<http://onlinebooks.library.upenn.edu>

- ◆ Project Gutenberg

<http://www.gutenberg.org>

### Video

- ◆ OpenFlix™

<http://www.openflix.com>

### Muzikë

- ◆ Gutenberg Music

<http://www.gutenberg.org/music>

- ◆ Mutopia

<http://www.ibiblio.org/mutopia>

- ◆ Sheet Music Digital

<http://www.sheetmusicdigital.com>

# CENIMI I TË

# DREJTAVE TË AUTORIT

## Çfarë është cenimi i të drejtave të autorit?

Cenimi ndodh kur vepra e mbrojtur përdoret (riprodhohet, përkthehet, adaptohet, ekspozohet ose performohet në publik, shpërndahet, transmetohet ose komunikohet me publikun) pa lejen e bartësit të të drejtave ose në kufizime të të drejtave të autorit.

**Cenimi i të drejtave të autorit** zvogëlon mundësitë që autorët të fitojnë të holla nga veprat e tyre dhe na dëmton gjithëve duke ulur nxitjen e autorëve për të krijuar vepra të reja që të gjithë të kënaqemi.

## Çfarë është plagjiatura?



**Plagjiatura** është akti i kopjimit të veprës, në tërësi ose pjesërisht dhe pastaj të bëhet sikur të jetë autori origjinal.

Siç mësuam në kapitullin më para, vetë idetë nuk janë të mbrojtura nga e drejta e autorit, andaj nuk ka asgjë të keqe për të shkruar për ndonjë ide që gjendet në ndonjë vepër tjetër. Mirëpo, për të shmangur plagjiaturë, duhet të shprehin idenë në mënyrën tonë unike.

Ndonjëherë një autor ka shprehur idenë aq mirë saqë nuk mund të e kishim thënë më mirë edhe me fjalët tona. Në këto raste, mund të kopjojmë tekstin e origjinalit fjalë për fjalë deri sa "thonjëzat" janë përdorur. Këto shenja informojnë lexuesin që teksti brenda është marrë nga vepra unike e ndonjë autori tjetër. Autori origjinal duhet të njihet në tekstin më larte ose më poshtë citatit ose me fusnotë.

Shumë shkolla, universitete dhe biznese kanë rregulla të rrepta kundër plagjiaturës. Ndonëse në internet është shumë lehtë të kopjohet ndonjë vepër e personit tjetër dhe të e bëni të juaj, pasojat e plagjiaturës mund të jenë shumë të rrepta. Studentët që bëjnë plagjiaturë rrezikojnë përjashtimin nga shkolla.

## Kujdes !!

Një kopje mund të konsiderohet si cenim edhe nëse nuk është e njëjta sikur vepra origjinale. Në fakt, cenimi ndodh kur kopja është pak e ngjashme. Kjo zakonisht përcaktohet në gjyq, gjatë të cilës krahasohen gjuha, pamja, formati, sekuenca, zëri, etj., të veprës origjinale dhe veprës që akuzohet për cenim.

Për të pasur cenim cenesi duhet të ketë pasur qasje në veprën origjinale. Në fund të fundit, mund të jetë e ngjashme që i akuzuari mund të ketë krijuar një vepër të ngjashme rastësisht, pa mos parë asnjëherë veprën origjinale. Nëse kjo është rasti, atëherë nuk kemi plagjiaturë.

## Çfarë është pirateria?



Termi **pirateri** zakonisht nënkupton shitjen e qëllimshme dhe të paligjshme të veprave me të drejtë të autorit.

Muzika është lloji i veprës që piratohet më shpesh, ndonëse veprat si filmat, video lojërat dhe softuerët Kompjuterik janë gjithashtu viktima të piraterisë. Pirateria është një aktivitet i paligjshëm që lëndon jo vetëm autorët, performuesit, prodhuesit e regjistrave të fonogrameve dhe transmetuesve por edhe shoqërinë në tërësi.

Kopjet e piratuar zakonisht shiten:

- ◆ me çmime shumë të ulëta;
- ◆ nga shitësit e rrugës në tregje, stenda dhe vende tjera joformale e jo në shitore të legalizuara;
- ◆ në disqe incizuese kompakte (CD-R);
- ◆ si MP3 përmbledhje të albumeve nga artistë të ndryshëm;
- ◆ me cilësi të dobët (pamje dhe tekst të zbehtë; letër të lirë dhe keq të prerë dhe me shtypje vetëm në një anë, fjalë me gabime dhe dorëshkrim; paketime të dobëta ose aspak të paketuara).
- ◆ pa asnjë © njoftime

Arsye përse nuk duhet të blejmë kopje të piratuar të veprave:

- 1) **Pirateria merr shpërblimin financiar të autorëve që meritojnë, dhe zvogëlon aftësinë e tyre për të vazhdat me punë.** Asnjë fitim nga shitja e CD-ve të piratuar nuk shkon tek autori ose performuesit e këngës në atë CD. Nëse autorët dhe performuesit nuk mund të fitojnë të holla nga shitja e veprave, atëherë ata duhet të gjejnë punë tjetër për të fituar. Kjo puna tjetër mund të konsumojë shumë kohën e tyre dhe nuk do të mund të vazhdojnë me krijimin dhe performimin e veprave të reja.

Fotografia prej: Associated Press



"Krijimi i albumit është punë ekipore andaj kur dikush piraton ndonjë incizim jo vetëm që ndikon mbi artistin por edhe njerëzit që kanë punuar në atë si autorët, baskëautorët dhe muzicientët. Thoni jo piraterisë." - Shakira në musicunited.org

- 2) **Pirateria zvogëlon nxitjen e kompanive publike dhe shpërndarëse për të investuar në autorë dhe performues të ri.** Kushton shumë të holla për të zbuluar, zhvilluar, incizuar dhe promovuar autorët e rinj dhe performuesit. Nëse, për shkak të piraterisë, publikuesit dhe shpërndarësit nuk mund të rikthejnë investimet e tyre për të bërë profit nga shitjet e veprave që ndihmojnë të prodhohet, ata do të kanë më pak financa për të investuar në autorë dhe performues. Kjo nënkupton që autorët e ri të panjohur dhe performuesit nuk do të kanë shansin e firmosjes së kontratës për publikim. Ajo gjithashtu nënkupton që konsumatorët do të kenë më pak zgjidhje nga muzika e re.
- 3) **Konsumatorët nuk janë të mbrojtur kundër kopjeve të prishura.** Cilësia e produkteve të piratuar zakonisht është më e ulët se origjinali. Kur konsumatorët kanë probleme me produkte legale, ata mund të ankohen në shitoren ku kanë blerë dhe ose i kthejnë të hollat ose kopje të re. Nga ana tjetër, kur konsumatorët blejnë kopje të piratuar, nuk ka garanci që mund të kthejnë të hollat ose



ndryshojnë produktin e prishur me një produkt funksional. Në shumë raste, ata nuk arrijnë të gjejnë shitësin pirat sërish!

- 4) **Pirateria i bën kopjet ligjore më të shtrenjta.** Për të mbuluar humbjet e tyre nga pirateria, publikuesit dhe shpërndarësit mund të rrisin çmimet e kopjeve ligjore të veprave.

### **Çfarë është shkëmbimi i skedarëve mes bashkëmoshatarëve? (peer-2-peer)**



**Peer-to-peer (P2P) shkëmbimi i skedarëve** është mënyra në të cilën përdoruesit e kompjuterëve në internet që janë lidhur me ndonjë rrjet shkëmbejnë skedarë kompjuterik (tekst, muzikë dhe/ose video).

Ngarkimi dhe shkarkimi që ndodh në 2P2 shkëmbimin e skedarëve përfshin kopjim dhe komunikim i veprave në publik - që të dy janë të drejta ekskluzive të autorit (ose bartësit të të drejtave) të veprës.

Andaj, kur bëhet pa lejen e bartësve, P2P shkëmbimi i skedarëve është cenim i të drejtave të autorit. Disa platforma 2P2 për janë shërbime legjitime, që marrin autorizime nga bartësit e të drejtave. Për fat të keq, vlerësohet që shumë rrjete P2P për shkëmbimin e skedarëve janë të paautorizuar dhe me këtë janë të paligjshme.

Kompjuterët, interneti dhe teknologjitë tjera digjitale si MP3 formate janë vegla të mrekullueshme që ndihmojnë të punojmë më shpejtë dhe të marrim informacione pakufi për botën. Mirëpo, këto vegla krijojnë edhe sfida të madhe për autorët duke bërë veprat e tyre më të prekshme. Me teknologjinë digjitale është më lirë dhe më lehtë të kopjohet dhe shpërndahen veprat në gjithë botën për disa sekonda. Ndonëse i duhen autorit vite për të kompozuar fjalët dhe melodinë interesante për një hit këngë, duhen vetëm disa sekonda që një përdorues kompjuteri të kopjojë atë këngë në skedar në kompjuter dhe të shpërndajë (në p2p rrjete) me miliona njerëz në gjithë globin.

Arsye përse nuk duhet të ngarkojmë/shkarkojmë kopje të paligjshme të veprave:

- 1) **Rreziku i viruseve kompjuterike dhe hakering.** Skedarët muzikor të shkarkuar mund të përmbajnë viruse. Përveç kësaj, P2P softueri mund ndonjëherë të përmbajë "spyware" që grumbullon informata për kompjuterin pa njohurinë ose pëlqimin e përdoruesit. P2P softueri që mundësojnë shpërndarjen e skedarëve muzikor mund gjithashtu të lejojnë të huajve të shikojnë skedarët tjerë në kompjuterin që përdoruesi nuk dëshiron të shpërndajë.
- 2) **Rreziku i padisë.** Interneti nuk është anonim, ka mundësi që të identifikohen individë që ilegalisht ngarkojnë dhe shkarkojnë material të mbrojtur në P2P rrjet. Prej 2003, industria muzikore ka treguar që do të padije përdoruesit ilegal, pa dallim nga mosha e tyre.
- 3) **Zvogëlimi i zgjedhjes muzikore.** P2P shkëmbimi ilegal i skedarëve zvogëlon blerjen e CD-ve të ligjshme, që nënkupton se studiot e incizimit e kanë më të vështirë të rikthejnë investimet e tyre në artistë. Me bërjen e investimit në talente të reja biznes të rrezikshëm, P2P shkëmbimi i skedarëve e bën më të vështirë që autorët dhe performuesit të firmosin marrëveshje. Studiot e incizimit gjithashtu mundohen të zvogëlojnë rrezikun të mos kthimit të investimeve të tyre duke prodhuar vetëm lloj mesatar të muzikës që njerëzit e preferojnë, duke e bërë më pak të mundshme që autorët origjinal dhe kreativ si dhe performuesit të tregojnë maksimumin.

Fotëderim prej: didomusic.com



"... sa më shumë bëhet shkarkimi i paligjshëm, aq më shumë kompani incizimi vuajnë, sa më tepër përqendrohen në artistë të mëdhenj dhe të vegjlit që me siguri bëjnë muzikë më të mirë nuk u jepet mundësia për tu dëgjuar." - Dido në whatsthe download.com

- 4) **Shkarkimi i muzikës se paligjshme është bërë lehtë.** Ekzistojnë qindra faqe ku muzika mund të shkarkohet ligjshëm, si me pagesë dëgjimi ashtu edhe me abonim. Ueb faqet më poshtë japin lidhje më të reja të shumë faqeve të ligjshme për shkarkim:  
<http://www.pro-music.org/musiconline.htm>

### Lojë: mbrojtja e autorëve dhe performuesve\*

Ju e kuptoni qëllimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura dhe dëshironi të respektoni të drejtat e autorëve dhe performuesve që i adhuron. A mund të gjeni se cilat prej këtyre veprimeve janë të ligjshme dhe cilat të paligjshme?



- |   |            |              |
|---|------------|--------------|
| 1) Kopjimi i CD-së së shokut të klasës për MP3 aparatin tënd:                                       | E ligjshme | E paligjshme |
| 2) Dhënia e CD-së një mikeshe që ke blerë për atësi dhuratë:  | E ligjshme | E paligjshme |
| 3) Dhënia e kopjes së CD-së që ke blerë për vete një shokut të klasës:                              | E ligjshme | E paligjshme |
| 4) Shkëmbimi i CD-së në P2P rrjet të paautorizuar:  | E ligjshme | E paligjshme |
| 5) Shitja e CD-së që ke blerë nga një shitje në garazh:   | E ligjshme | E paligjshme |
| 6) Ngarkimi i një kënge të shkruar, kompozuar dhe performuar nga ju në ueb faqe për shkarkim falas: | E ligjshme | E paligjshme |
| 7) Dërgimi i MP3 skedarit me këngën e preferuar me postë elektronike një shoku të klasës:           | E ligjshme | E paligjshme |

\* Shikoni faqen 60 për përgjigjet

## Çfarë është administrimi i të drejtave digjitale?

Për të mbrojtur veprat e tyre nga cenimi, bartësit e të drejtave përdorin veglat e njëjta që kanë bërë veprat e tyre të prekshme - teknologjitë digjitale. Përdorimi i këtyre teknologjive nga ana e tyre, që e bën cenimin e të drejtave të autorit më të vështirë dhe e lehtëson administrimin e të drejtave, është e njohur si **administrimi i të drejtave digjitale (ADD)**.

ADD veglat mund të përdoren për të shënuar veprat digjitale me informatat e të drejtat e autorit. Ato mund të përdoren për të kontrolluar mënyrën në të cilën përdoret vepra. Për shembull, ADD-ja mund të kufizojë numrin e kopjeve që mund të bëhen nga vepra, mund të parandalojë ndryshime që bëhen veprës dhe mund të kufizojë aparatet në të cilat mund të përdoret vepra.

Sipas ligjeve ndërkombëtare, nuk lejohet largimi, ndryshimi (largimi) ose tejkalimi (rrethimi) i ADD mbrojtjes së ndonjë vepre.

## Si mund të mbrohen veprat në internet?

Si autor, ndoshta dëshironi që të bëni veprën e juaj të lirshëm për njerëzit tjerë duke e vendosur në internet, duke mbajtur gjitha të drejtat që të jepen me të drejtat e autorit. Hapin e parë që duhet bërë është të vendosni <sup>©</sup> njoftimin me emrin e juaj dhe vitet në ueb faqen. Gjithashtu, duhet të përfshini edhe Termet e Përdorimit seksionin ku saktë përcaktoni se çfarë lejoni dhe nuk lejoni që tjerët të bëjnë me veprën e juaj. Për shembull, mund të lejoni që vizitorët të printojnë poemën e juaj ose vizatimet për përdorimin e tyre personal por ndalohen nga shitja e këtyre veprave pa pëlqimin e juaj.

Kur të ngarkoni materialin e ri origjinal në ueb faqen e juaj, printoni një kopje me datat për regjistrat e juaj. Kjo kopje mund të nevojitet në të ardhmen për të dëshmuar që ishit personi i parë për të ngarkuar këtë informacion në internet.

Mund të konsideroni përdorimin e ADD teknologjive për mbrojtje plotësuese. Për shembull, mund të përdorni shenja ujore me emrin e juaj në gjitha fotografitë që nëse njerëzit i printojnë ose kopjojnë, emri i juaj çdoherë do të paraqitet në fotografinë. Mund të zgjidhni të ngarkoni vetëm incizime me cilësi të ulët ose version e të përgjysmuara të veprës së juaj për të ndaluar kopjimin.

Shenjat ujore janë një lloj i ADD që mund të ndihmojnë në mbrojtjen e fotografive të mbrojtura nga përdorim i paautorizuar.



Nëse edhe përsëri njoftimeve për të drejta të autorit dhe masa mbrojtëse zbuloni që veprat e juaja ende përdoren pa lejen e juaj, duhet të kontaktoni cenesin. Fillimisht, printoni një kopje të materiale në faqen e cenuar (me datën e qartë) që cenesi nuk do të mund lehtë të fshijë materialin dhe të shtirret sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Gjeni kontakt detajet e cenesit dhe dërgoni një postë elektronike duke theksuar që juve jeni autori dhe pronari i të drejtave të autorit të veprës specifike që gjendet në ueb faqen cenuese. Pastaj, mund të kërkoni nga cenesi që të 1) largojë materialin e mbrojtur nga ueb faqja menjëherë, 2) të vendos juve si autor i materialit, dhe/ose 3) të paguajë shumën mbretërore për përfshirjen e kësaj veprë në ueb faqen. Jepni cenesit një afat për të përgjigjur mesazhit dhe të bëjë atë që keni kërkuar për veprën e juaj.

Për fat të keq, shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm për ligjet e të drejtave të autorit andaj ka mundësi të cenes nuk e dinë që publikimi i veprës së juaj pa leje është e paligjshme. Sigurisht që cenesi do të mundohet të rregullojë problemin me shpejtësi dhe të dërgojë mesazh ndjese. Nëse kjo nuk ndodh, duhet të angazhoni një avokat dhe të dërgoni një letër juridike "Ndalo dhe ndërpre" dhe në fund ndëshkojeni cenesin. Avokati mund gjithashtu të ndihmojë për të njoftuar internet servisit që bën hosting ueb faqes për cenimin.

## Lojë: Gjejeni cenimin\*

A mund të gjeni pjesë në ueb faqen fiktive më poshtë ku të drejtat e autorit janë cenuar?

The screenshot shows a web browser window titled "OneWorld Weblogs -". The address bar contains "http://www.anaswebpage.net". The page content is as follows:

**Ana's WebPage**  
*Welcome to my site !*

**MUSIC**  
Dëgjoni MP3 skedarët e ri me kompozimet më të reja<sup>(1)</sup> tone celulare më të reja<sup>(2)</sup> dhe incizime të grupit më të preferuar timin.<sup>(3)</sup>

**POETRY**  
Më tregoni se çfarë mendoni për poemat e mia<sup>(4)</sup> dhe lexoni veprat origjinale poemat tjera<sup>(5)</sup> që më kanë inspiruar.

**PHOTOS**  
Shikoni këto fotografi të bukura që kam bërë vitin e kaluar në Paris.<sup>(6)</sup> Mos i lëshoni fotografitë mahnitëse<sup>(7)</sup> të aktorëve të preferuar që kam skanuar.


**MOVIES**  
Shkarkoni video shtëpiake gesharake<sup>(8)</sup> ose ndiqni lidhjet për faqet zyrtare<sup>(9)</sup> të filmave më të preferuara.

\* Shikoni faqen 61 për përgjigjet.





# MENDIME TË FUNDIT



Bota në të cilën jetojmë është rrethuar me art. Prej këngëve që këndojmë në dush, deri në ditarin që shkruajmë, librat që lexojmë, filmat që shikojmë dhe video lojërat që luajmë - dita jonë është mbushur me shprehje artistike të krijuar nga vetja dhe tjerët.




Gjeni shprehjen artistike që më tepër ju konvenon dhe përdorni imagjinatën e juaj për të krijuar vepra të reja dhe origjinale. Kërkoni inspirim në veprat e autorëve tjerë dhe respektoni të drejtat e tyre për t'i inkurajuar të vazhdojnë me krijimin e veprave që do të tronditin.




# PËRNGJIGJET E LOJËRAVE

## Lojë: Bashkimi i emrit me veprën e autorëve të rinj



Beethoveni publikoi veprën e parë muzikore në moshën 12 vjeçe. Këtë vepra quhen Variacionet Dresler.



Frida Kahlo pikturoi veten në vetë-portret, Gruaja në Fustanin e Kuq, kur ishte 19 vjeçe,



Mary Shelley filloi të shkruajë Frankenshtajn kur ishte 18 vjeç.



Mocarti shkroi kompozimin e tij të parë, Andante në C në moshën 5 vjeçe.



Pikaso kompletoi pikturën e tij të njohur, Le Picador, në moshën 8 vjeçe.



Walt Disney shiti vizatimet e tij në moshën 7 vjeçe.

© Disney Enterprises, Inc.


## Lojë: Detektivi i të drejtave të autorit

**Armando Chico** është pronar i të drejtave morale të origjinalit. Teksti në portugalisht.

**J. Little** është pronar i të drejtave morale të përkthimit të tekstit në anglisht.

**Carlos Mayorga** është pronar i të drejtave të autorit të dizajnit në kopertinën.

**XYZ Publishers** është pronar i të drejtave të publikimit.



Të drejtat ekonomike të përfshira në referencën "të gjitha të drejtat e rezervuar" mbulojnë gjitha përdorimet relevante të veprës, qenë ajo e licencuar ose transferuar ose të mbeten me autorin. Këto përfshijnë të drejta për të: **riprodhuar, përkthyer, adaptuar, ekspozuar ose performuar** veprën në publik; **shpërndarja, transmetimi dhe komunikimi** i veprës para publikut.

### Lojë: Caktoni të drejtat



Do të duhet leje nga **The Blueberries** për të kënduar Indigo këngën gjatë performancës së grupit të juaj para publikut.

Do të duhet leje nga **123 Record's** për të ngarkuar albumin në internet faqen e juaj. Autorizimi nga ana e autorit dhe performuesit (The Blueberries) do të jetë i nevojshëm përveç nëse të drejtat që përfshijnë eksploatimin digjital (riprodhim, disponueshmëria) nuk janë të transferuar në prodhuesin.

Do të duhet leje nga **Carlos Mayorga's** për të riprodhuar dizajnin e kopertinës në fanellë.


Parimisht, do të duhet leje nga **The Blueberries'** (autorët) për të transmetuar Indigo këngën në radio stacionin vijues. Në shumë vende, performuesit dhe kompanitë e incizimit (123 Record) gjithashtu kanë të drejtë për kompensim.

Do të duhet leje nga **The Blueberries'** për të incizuar melodinë e Indigo këngës për të përdorur si muzikë prapavije për filmin që jeni duke krijuar.


Do të duhet leje nga **The Blueberries'** për të përdorur tekstin e refrenit të këngës Indigo si pjesë e këngës që jeni duke kompozuar.

## Lojë: Detektivi i domenit publik

Kanë kaluar më pak se 70 vite prej vdekjes së autorëve të veprave më poshtë, por ende nuk janë në domenin publik:



*Aventurat e  
Tintin*



*Luani, Shtriga dhe  
Garderoba*










*Çarli dhe fabrika e  
çokollatës*



*Pipi me çorapet  
e gjata*

## Lojë: Mbrojtja e autorëve dhe performuesve

- 1)  Kopjimi i CD-së së shokut të klasës për MP3 aparatit tënd është **e paligjshme**.
- 2)  Dhënia e CD-së një mikeshë që ke blerë për atë si dhuratë është **e ligjshme** sipas doktrinës së shkallës së parë.
- 3)  Dhënia e kopjes së CD-së që ke blerë për vete një shokut të klasës është **e paligjshme**.
- 4)  Shkëmbimi i CD-së në P2P rrjet të paautorizuar është **e paligjshme**.
- 5)  Shitja e CD-së që ke blerë nga një shitje në garazh është **e ligjshme** sipas doktrinës së shkallës së parë.
- 6)  Ngarkimi i një kënge të shkruar, kompozuar dhe performuar nga ju në ueb faqe për shkarkim falas është **e ligjshme**, sepse si autor, ju mund të bëni çfarë të dëshironi me veprën që keni krijuar.
- 7)  Dërgimi i MP3 skedarit me këngën e preferuar me postë elektronike një shoku të klasës është **e paligjshme**.

## Lojë: Gjejeni cenimin

Përveç nëse Ana nuk ka marrë leje nga bartësit e të drejtave dhe/ose siguruar që veprat janë në domenin publik, ajo me siguri ka cenuar të drejtat e autorit duke ngarkuar skedarët më poshtë në ueb faqen e saj: (2) tone celulare më të reja / (3) incizime të grupit më të preferuar timin / (5) poema origjinale nga autorë tjerë/ (7) fotografi të aktorëve të preferuar që kam skanuar.

Meqë ajo është autore e veprave më poshtë, ajo mund të bëjë çfarë të dëshirojë me ata, përfshirë edhe ngarkimin e tyre në ueb faqe:

(1) kompozimet më të reja / (4) poemat e mia / (6) fotografi të bukura që kam bërë vitin e kaluar në Paris / (8) video shtëpiake qesharake.

Me lidhjen në faqe tjetër (klikoni lidhjet për faqet zyrtare të filmave të preferuar (9)) nuk është cenim i të drejtave të autorit, ajo konsiderohet një kërkesë për ueb faqen nëse Ana mund të shtojë lidhjen në ueb faqen e saj. Nëse ajo dëshiron të përdor logon ueb faqes që lidhet, ajo patjetër duhet të kërkojë leje.

# LETRA PËR

# KËRKIMIN E LEJES

Para përdorimit (kopjimit, adaptimit, interpretimit, shpërndarjen, etj.) të një vepre të mbrojtur me të drejtat e autorit, duhet të kërkoni leje nga autori ose bartësit tjerë të drejtave të autorit. Kjo leje zakonisht mund të kërkohet me anë të letrës ose postës elektronike.

Ndonjëherë, pjesa më e vështirë e kërkimit të lejes është identifikimi dhe gjeta e informatave për kontaktim të bartësve të drejtave të autorit. Nëse autori i veprës që dëshironi të përdorni ka ndërruar jetë ose në mënyrë tjetër ka transferuar të drejtat e tija, do të duhet të bëni një hulumtim të vogël që të gjeni bartësin momental të të drejtave të autorit.

- ◆ Për materiale të printuara (libra, revista, fotografi, etj.) më mirë është të fillohet me kontaktimin e botuesve (informatat e tyre të kontaktit zakonisht gjenden në fillim të materialit të botuar). Edhe nëse botuesit nuk i kanë të drejtat e autorit, zakonisht mund të ju tregojnë se kujt duhet ti drejtoheni.
- ◆ Për produkte multimediale sikur filmat dhe TV programet, njoftimi mbi të drejtat e autorit paraqitet në fund të filmit ose programit, dhe kjo do t'ju tregojë se kujt duhet të ja dërgoni kërkesën për leje. Kjo informatë mbi të drejtat e autorit gjithashtu mund të gjendet edhe në paketimet e DVD-ve dhe videove.
- ◆ Ueb faqet zakonisht kanë informata mbi politikën e tyre të të drejtave të autorit në pjesën mbi Termat e Përdorimit. Pjesa me Kontaktin zakonisht jep një e-mail adresë ku mund të dërgoni kërkesën për përdorim.
- ◆ Sa i përket muzikës, mbani në mend se ka të drejta të lidhura dhe të drejta të autorit që duhen marrë parasysh. Nëse dëshironi të përdorni



vetëm fletën e muzikës, duhet të kontaktoni autorin (ose publikuesin e muzikës). Sidoqoftë, nëse dëshironi të përdorni incizim, duhet të kontaktoni autorin (ose publikuesin) e muzikës dhe gjithashtu edhe producentin e incizimit. Informacionet e personit që duhet kontaktuar mund të gjenden në fletën e muzikës ose paketimin e CD-së. Veç kësaj, mund të kontaktoni agjenci për administrim kolektiv që mund të ju ndihmon të identifikoni dhe gjeni bartësit e të drejtave.

- ◆ Në disa shtete, sistemi publik i regjistrimit mund të siguron informatat e duhura për kontaktim të autorit të veprës. Kuptoni nëse shteti juaj ka një sistem të tillë të regjistrimit, kontaktoni me zyrën kombëtare për të drejtat e autorit.

Pasi të dini se kë do të kontaktoni, duhet të filloni me përgatitjen e letrës. Letrat për kërkim të lejes duhet:

- ◆ Përfshijnë datën, emrin dhe informatat e kontaktit të bartësit të drejtave të autorit.
- ◆ Shkurtimisht shpjegoni kush jeni dhe në çfarë projekti punoni (shkaqet pse doni të përdorni veprën).
- ◆ Përfshini informata të detajuara mbi veprën (ose pjesë të caktuar të veprës) që dëshironi të përdorni. Përdorni ISBN numrat për identifikim të botimit të saktë të librave dhe URL lidhjet për veprat në Internet.
- ◆ Shpjegoni në detaje se si do të përdoret vepra. Për shembull: sa kopje të veprës dëshironi të bëni; ku dhe për çfarë publiku dëshironi të adaptoni veprën (ta përktheni, ta përdorni një pjesë të veprës në veprën tuaj të re, etj.); ose si planifikoni të shpërndani veprën (ta ngarkoni në ueb faqe, të shitni kopje të printuara, etj.).

- ◆ Të kërkon vërtetim se personi të cilit i është drejtuar letra me të vërtet është bartësi i vetëm i vërtet, dhe të kërkon informata mbi bartës tjerë që duhet të kontaktoni.
- ◆ Kërkojnë autorizim për përdorim të veprës sikur e përshkruar.
- ◆ Pyetur për mënyrën në të cilën bartësi i të drejtave dëshiron të kreditojë veprën.
- ◆ Informojë bartësin e të drejtave për afatin e pranimit të lejes. Mundohuni të dërgoni kërkesën për leje me mjaft kohë për të arritur afatin e juaj por mbani mend që bartësi i të drejtave nuk është i obliguar të përgjigjet letrës së juaj. Nëse nuk përgjigjet, ajo nuk nënkupton që keni leje për të përdorur veprën e tij.
- ◆ Përfshijë kontakt detajet e juaja.



## Modeli i letrës për kërkimin e lejes:

[Emri i bartësit të të drejtave]

[Adresa e bartësit të të drejtave]

[Data]

I nderuar [emri i bartësit të të drejtave]:

Unë jam [përshkrim i shkurtë i vetvetes si "muzikant i ri" ose "studenti i artit"] dhe momentalisht punoj në [përshkrim i shkurtë i projektit të juaj si "ushtrimi i këngëve për dramën shkollore" ose "zgjedhja e shembujve të veprave për një projekt në ueb faqe"].

Kam mësuar që juve i keni të drejtat e autorit për [titulli i veprës që doni të përdorni, përshini ISBN numrin ose URL lidhjen nëse i keni] dhe kërkojmë lejen e juaj për të [përshkruani si dëshironi të përdorni veprën - për shembull: performoni, kopjoni, ngarkoni në ueb faqe, përktheni, etj.] këtë vepër. [Përshini më tepër informacione si do të përdoret vepra. Për shembull, kur planifikoni të performoni veprën dhe kush do të shikojë performancën; sa kopje të veprës dëshironi të bëni dhe ku do të shpërndahen këto kopje; kush ka qasje në ueb faqen që dëshironi të ngarkoni veprën; a planifikoni të kërkonte pagesë për performancën, kopjet, përdorimin e ueb faqes; etj.]. Afati për përfundimin e këtij projekti është [data që duhet të merrni përgjigje nga e bartësi i të drejtave].

Ju lus që të përgjigjeni në adresën më poshtë nëse jeni dakord për të më dhënë leje për përdorimin e veprës në mënyrën e përmendur më lartë. Nëse nuk jeni bartësi i vetëm i të drejtave për këtë vepër, më informoni se kë tjetër duhet të kontaktoj për të kërkuar leje. Gjithashtu, më tregoni nëse keni ndonjë preferencë për mënyrë si duhet të përdor veprën e juaj.

Ju falënderoj paraprakisht për konsideratën e kësaj kërkesë.

Sinqerisht,

[emri juaj]

[kontakt detajet e juaja përfshirë adresën postare dhe e-mailin]



# FJALORTH

**Administrimi i të drejtave digjitale (ADD)** - Teknologjia digjitale që zbatohet nga bartësit e të drejtave për të vështirësuar përdorimin e paligjshëm dhe të lehtësojnë administrimin e të drejtave të tyre.

**Autor** - Si rregull e përgjithshme, autori është krijuesi i veprës.

**Agjencia për Administrim Kolektiv** - Organizatë që ndihmon autorët, performuesit, prodhuesit e regjistrave fonografike dhe/ose transmetuesit të administrojnë të drejtat e tyre. Ajo mbledh pagesën nga përdoruesit dhe i shpërndan bartësve të të drejtave.

**Bartësi i të drejtave** - Pronari i të drejtave të autorit ose të drejtave të lidhur të një vepre.

**Cenimi i të drejtave të autorit** - Përdorimi i veprës së mbrojtur pa autorizimin e bartësit të të drejtave ose nën kufizim të të drejtës së autorit.

**Detyrë** - Mënyra e transferimit të një ose më tepër të drejta ekonomike të autorit që personi që blen të drejtat bëhet pronari i ri i të drejtave të autorit.

**Doktrina e shkallës së parë** - Një rregull që tregon se e drejta e autorit për të shpërndarë çdo kopje të veprës përfundon me shkallën e parë të kopjes specifike.

**Domeni publik** - Koleksioni i gjitha veprave që nuk janë të mbrojtura me të drejtë të autorit dhe janë të lirë për përdorim pa leje ose pagesë për autorin.

**E drejta e autorit** - Një sërë të drejtash që jepen autorëve të veprave origjinale. Ndonjëherë "e drejta e autorit" në raste të caktuara përdoren për të mbuluar të drejtat e lidhura.

**Konventa e Bernit** - Marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e autori, që ofron një pako minimale të të drejtave për autorët e shteteve që janë anëtare të Konventës.

**Licencë** - Leje zyrtare për të zhvilluar një vepër që zakonisht është e rezervuar për autorin e veprës.

**Leje nisjeje** - Procesi i kërkimit të lejes dhe pagesës së shumave për bartësit e të drejtave për përdorim të veprës së mbrojtur.

**Organizata Botërore e Pronës Intelektuale (OBPI)** - Organizata Botërore e Pronës Intelektuale, agjenci e Kombeve të Bashkuara e specializuar me seli në Gjenevë, dedikuar në promovimin e të drejtave pronësore intelektuale të artistëve dhe shpikësve.

**Pagesat mbretërore** - Pagesa e bërë ndonjë autori nga personi që përdor materialin e tij të mbrojtur.

**Pirateri** - Zakonisht nënkupton shitjen e qëllimshme dhe paligjshme të veprave me të drejta të autorit.

**Plagjiaturë** - Akti i prezantimit të veprës së ndonjë personi si të juaj.

**Prona industriale** - Një lloj i pronës intelektuale, që përfshin patentë, shenja dalluese dhe dizajne industriale.

**Prona intelektuale** - Degë e ligjit që mbron krijimet e trurit të njeriut. Ajo ndahet në pronë industriale dhe të drejta të autorit.

**Shkëmbimi i skedarëve mes bashkëmoshatarëve (Peer-to-peer file sharing)** - Një mënyrë në të cilën përdorues të ndryshëm kompjuterik në internet që janë kyçur në rrjetin e njëjtë mund të shpërndajnë skedarë (tekst, muzikë dhe/ose video).

**Të drejta ekonomike** - Të drejta ekskluzive dhe kompensimi që mundëson bartësin e të drejtave të përfitojë financiarisht nga vepra. Këto përfshijnë të drejtën për riprodhim, përkthim, adaptim, ekspozim ose performuar veprën, shpërndarja, transmetimi dhe komunikimi i veprës para publikut.

**Të drejta morale** - Të drejtat e maternitetit dhe integritetit, që mirëmbajnë lidhje personale mes autorit dhe veprës së tij.

**Të drejta të lidhura** - Të drejtat e performuesve, prodhuesve dhe regjistrave fonografike, dhe organizatave transmetuese.

**Vepër** - Shprehja origjinale artistike.

**Vepra derivate** - Adaptim ose përkthim i veprave origjinale. Veprat derivate gjithashtu janë të mbrojtura me të drejtat të autorit.

**Vepër kolektive** - Vepër e krijuar nga më shumë se një autor.



# REKOMANDIME TJERA

Broshurat falas më poshtë të publikuar nga OBPI ofrojnë më tepër informata mbi patentat dhe format tjera të pronës intelektuale. Mund t'i shkarkoni në lidhjen [www.wipo.int/publications](http://www.wipo.int/publications). Mund të kërkonte edhe kopje të shtypur duke dërguar e-mail në [publications.mail@wipo.int](mailto:publications.mail@wipo.int).

Të drejtat e autorit



Pub. Nr. 484

Patenta




Pub. Nr. 485

Shenja dalluese




Pub. Nr. 483

Mësoni nga e kaluara, krijoni ardhmërinë: Shpikjet dhe patentët



Pub. Nr. 925

Bota juaj e IP




Pub. Nr. 907

Në shtëpi me Shpikje




Pub. No. 865

Çfarë është prona intelektuale?



Pub. Nr. 450

Nga artisti në audiencë



Pub. Nr. 922

Shpikja e ardhmërisë



Pub. Nr. 917

Pamja e pashme




Pub. Nr. 498

Vendosja e shenjës



Pub. Nr. 900

Shprehja kreative



Pub. Nr. 918

# BIBLIOGRAFIA

## E ZGJEDHUR

Dikins, Rosie and Mari Griffith  
*The Usborne Introduction to Art*  
London: Usborne Publishing Ltd., 2003

Fishman, Stephen  
*The Public Domain: How to Find Copyright-Free Writings, Music, Art & More*  
Berkeley, CA: Nolo, 2000

Pimont, Marie-Renée  
*L'imagerie des Arts*  
Paris: Éditions FLEURUS, 2002

World Intellectual Property Organization (WIPO)  
*Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works*  
Geneva: WIPO, 1979

World Intellectual Property Organization (WIPO)  
*Intellectual Property Handbook*  
Geneva: WIPO, 2004

# BURIME NË INTERNET

Copyright Kids

<http://www.copyrightkids.org>

G.U.R.I

<http://www2.inpi.gov.br/Guri/index.jsp>

IP Kids

<http://www.ip-kids.gov.hk>

Iperckidz

<http://app.ipos.gov.sg/iperckidz/index.asp>

ProMusic

<http://www.pro-music.org>

Plaza de los niños

[http://www.derautor.gov.co/htm/Cartilla/plaza\\_de\\_los\\_ni%F1os.htm](http://www.derautor.gov.co/htm/Cartilla/plaza_de_los_ni%F1os.htm)

What's the Download

<http://www.whatsthe-download.com>

# SHËNIME PËR MËSIMDHËNËSIT

Ky publikim mund të përdoret si plotësim i planit mësimor për lëndën e shkencës, veçanërisht për projekte të panairëve shkencore. Seksionet "Mendoni" mund të jenë pikë nisëse për diskutime në klasë mbi rëndësinë e arteve dhe të drejtat e autorit.

Mësimdhënësit mund të plotësojnë këtë publikim me sesion në klasë që do të mbulojnë informacione më specifike të ligjeve përkatëse të të drejtave të autorit. Këto informacione mund të gjenden në CLEA bazën me të dhëna të OBPI-së <http://www.wipo.int/clea/en/index.jsp>

Inkurajohen nxënësit të kompletojnë Aktivitetin për Krijimtari për të kuptuar përpjekjet dhe numrin e personave të përfshirë në krijimin, prodhimin, performimin dhe shpërndarjen e veprës origjinale.

Në fund, mësimdhënësit mund të përdorin këtë publikim për të nxitur nxënësit e tyre të krijojnë më tepër vepra origjinale, të njohin të drejtat e këtyre veprave dhe të respektojnë të drejtat e krijuesve tjerë.

Ky publikim mund të fotokopjohet për përdorim në klasë në formën aktuale, pa asnjë ndryshim.

Për komente, pyetje dhe kërkesa, ju lutemi të na kontaktoni [kids@wipo.int](mailto:kids@wipo.int).

Për më tepër informata, kontaktoni OBPI në [www.wipo.int](http://www.wipo.int)

**Organizata Botërore e Pronës Intelektuale**

34, chemin des Colombettes

P.O. Box 18

CH-1211 Gjenevë 20

Zvicër

Telefon:

+41 22 338 91 11

Faks:

+41 22 733 54 28